|------------|---------------------------------------------------------|------|
| <b>DFE</b> | 04/25-06 [20kV] - Gadime                                | 2026 |
|            | 04/25-10 [20kV]- Sllovia                                |      |
| <b>DPE</b> | 05/25-08 [20kV] - Onix & Vrella                         |      |
| <b>DPZ</b> | 03/26-05 [20kV] - Peqani                                |      |
|            | 03/26-06 [10&20kV] - Bodrumi & Dalja e re Hasi I        |      |
| <b>DFE</b> | 04/27-14 [20kV] – Konjuh & Banulla                      | 2027 |
|            | 04/27-13 [20kV] - Daljet në Qendrën e Qytetit në Lipjan |      |
| <b>DPZ</b> | 03/27-11 [20kV] - Budakova                              |      |
| <b>DFE</b> | 04/28-06 [20kV] - Fshatrat                              | 2028 |
| <b>DPE</b> | 05/28-09 [20kV] - Gllareva                              |      |
| <b>DPR</b> | 01/29-09 [20kV] - Lumi i Madh-Prugovc & Millosheva      | 2029 |
| <b>DPZ</b> | 03/29-11 [20kV] - Restelica                             |      |
| <b>DFE</b> | 04/29-01 [20kV] - Gaçka                                 |      |
|            | 04/29-04 [20kV] - Drenica                               |      |
| <b>DPE</b> | 05/29-03 [20kV] - Juniku                                |      |
| <b>DPE</b> | 05/30-01 [20kV] - Fusha e Pejës                         | 2030 |
| <b>DGJ</b> | 08/30-12 [20kV] - Ratkoci                               |      |

*Në pjesën SHTOJCA 1 të raportit gjenden më shumë detaje të gjendjes pas investimit të daljeve të përfshira në investime.*

#### **4.8 Projektet në Nënstacione për përkrahjen e kalimit të daljeve 10 [kV] në 20 [kV]**

**NS Vushtrria I 35/20 [kV]:** Daljet në qendrën e qytetit në Vushtri po mbingarkohen vazhdimisht, dhe në Nënstacion nuk ka hapësirë të lirë për vendosjen e kthinave të reja, ashtu që të krijohen dalje të reja.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 28 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Është planifikuar të implementohet një NS Vushtrria I 35/20 [kV], i cili do të furnizohet nga Vushtrria 1 110/35 [kV]. Ky NS do të furnizoj daljet Novolani dhe Stacioni Hekurudhor, pasi që këto dy dalje në gjendjen ekzistuese janë të mbingarkuara.




Figura 2. Skema njëpolare e propozuar për NS 35/20 [kV] Vushtrria I.

**NS Xërxa 35/10(20) [kV]:** Nga NS Xërxa furnizohet dalja Dejuni, e cila dalje në periudhën e ardhshme do të konvertohet në 20 [kV]. Për tu realizuar ky konvertim, TR 2 do të operoj në 35/20 [kV], kurse TR 1 do të operoj në 35/10 [kV], si në figurën e mëposhtme.




Figura 3. Skema njëpolare e propozuar për NS Xërxa.

**NS Pirana 35/10(20) [kV]:** Dalja Hasi II dhe Dalja e re e krijuar nga transformatorët e daljes Bodrumi do të furnizohen nga NS Pirana në nivelin 20 [kV]. Për tu realizuar kjo, TR 2 8 [MVA] do të operoj në nivelin 20 [kV].

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 29 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |




Figura 4. Skema njëpolare e propozuar për NS Pirana.

**NS Gurakoci 35/10(20) [kV]:** Dalja Onixi është planifikuar të operoj në nivelin 20 [kV]. Për t'u arritur kjo do të shtohet kapaciteti transformues në NS nga (4+8) [MVA] në 8+8 [MVA], ku një TR do të furnizoj daljen e Onix-it kurse TR tjetër pjesën e mbetur të daljeve.




Figura 5. Skema njëpolare e propozuar për NS Gurakoci.

**NS Mazgiti 35/10(20) [kV]:** Dalja Lumi i Madh – Prugovc & Millosheva është planifikuar të operoj në nivelin 20 [kV]. Për të operuar në 20 [kV], nga nënstacioni Mazgiti 35/10(20) [kV], një transformator ekzistues 8 [MVA] do të operojë në nivelin 20 [kV].

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PEŠË VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 30 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |




Figura 6. Skema njëpolare e propozuar për NS Mazgiti.

#### 4.9 Projektet për zgjerim dhe përforcim të rrjetit 0.4 [kV]

Një nga hapat e parë të planifikimit është parashikimi i kërkesës së ardhshme për energji elektrike me detaje gjeografike të mjaftueshme për të planifikuar kapacitetin dhe vendndodhjen e elementeve të sistemit shpërndarës, që do të jetë bazë për zgjerim dhe përforcim të rrjetit (ZPRr). Parashikimi i kërkesës tregon shkallën për të cilën do të rritet ngarkesa brenda një rajoni gjeografik, e cila është e nevojshme për të përcaktuar kapacitetet dhe shpërndarjen e elementeve brenda një zone të caktuar.

Projektet ZPRr janë projekte që parashikohen për shkak të trendit në rritje të vazhdueshme të konsumit. Në projektet ZPRr, kapaciteti dhe vendndodhja e nënstacioneve TM/TU ndryshon duke shtuar NS-e të reja, duke rritur fuqinë e transformatorëve ekzistues, duke zhvendosur NS-et me qëllim të shpërndarjes optimale të ngarkesës si dhe duke e përforcuar rrjetin e TM dhe rrjetin e TU. Këto projekte janë të orientuara kryesisht në investimet në rrjetin e tensionit të ulët.

Qëllimet kryesore të projekteve për përforcim të rrjetit janë:

- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe zvogëlimi i humbjeve teknike, dhe
- Qasje më e lehtë në pikën matëse dhe reduktim i humbjeve jo-teknike

Përfitimet e pritshme përfshijnë: furnizim të qëndrueshëm të energjisë, përmirësimin e kualitetit të tensionit, reduktimin e humbjeve teknike dhe jo-teknike dhe përmirësimin e topologjisë së rrjetit.

Projektet ZPRr ofrojnë zgjidhje për lloje të ndryshme të problemeve, dhe atë në:

- Identifikimin e nënstacioneve të reja për konsumatorët që kanë probleme me rënie të tensionit dhe humbje të mëdha teknike dhe jo-teknike
- Identifikimin e zonave me rritjen më të lartë të parashikuar të ngarkesës
- Parapërgatitjen e rrjetit shpërndarës për konsumatorët e ardhshëm që pritet të vendosen në zona të caktuara
- Identifikimin e NS-ve ekzistuese në të cilat kërkohet rritje e kapacitetit të TR-ve për shkak të mbingarkesës
- Planifikimin e daljeve shtesë të TU në rastet e mbingarkesave

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 31 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

Projektet e përforcimit të rrjetit janë të ndërthurura kryesisht me projektet MMO dhe PLC. Këto projekte të rehabilitimit përfshijnë disa pika si në vazhdim:

- Ndërtimi i transformatorëve distributiv të rinj 10(20)/0.4 [kV] në një regjion apo më shumë ku vlera e humbjeve teknike dhe jo-teknike në rrjetin e tensionit të ulët është shumë e madhe
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues 10 [kV] deri te transformatori i ri
- Rehabilitimi i rrjetit ekzistues ose ndërtimi i rrjetit të ri në TU
- Montimi i kutive (kuadrove) nëpër shtylla nëse është rrjet ajror dhe nëpër kuadro të tokës nëse është rrjet nëntokësor
- Vendosja, gjegjësisht bartja e njehsorëve prej shtëpive për t'u vendosur nëpër kuadrot e montuar në shtylla
- Ndërrimi i njehsorëve mekanik me ata 'të mençur', dhe
- Montimi i PLC-ve

Për vitet 2026 -2030 janë paraqitur të dhënat lidhur me këto projekte të ndara në distrikte.

*Tabela 15. Investimet në TU për vitin 2026 - 2030.*

| Vitet e Investimit     | Distriktet | Numri i    | Numri i       | Përfitimi nga |
|------------------------|------------|------------|---------------|---------------|
|                        |            | Projekteve | Konsumatorëve | Humbjet (MWh) |
| <b>2026- 2030</b>      | Prishtina  | 29         | 5871          | 10,193.56     |
|                        | Prizren    | 33         | 7464          | 4,421.52      |
|                        | Mitrovica  | 28         | 4750          | 11,676.71     |
|                        | Ferizaj    | 27         | 5372          | 5,098.92      |
|                        | Peja       | 49         | 5715          | 10,969.35     |
|                        | Gjilani    | 7          | 2015          | 668.00        |
|                        | Gjakova    | 10         | 1645          | 1,193.54      |
| <b>Total 2026-2030</b> |            | 183        | 32832         | 44,221.61     |

Në këtë tabelë janë përfshirë edhe projektet e aprovuara në vitin 2025, implementimi i të cilave do të vazhdojë gjatë vitit 2026. Po ashtu, në vitin 2026 janë përfshirë edhe projektet Janjevë (TS Virovci), Janjevë (TS Policia) dhe projekti i Cërnushës. Ndërsa projekte Zhazh 1 dhe Zhazh 2 janë përfshirë në listën e projekteve në Mitrovicën e Veriut.

#### **4.10 Projektet e rrjetit të mençur (Smart Grid)**

Menaxhimi i sistemit elektroenergjetik shpërndarës, mirëmbajtja e tij, kontrollimi dhe monitorimi janë sfidat kryesore të kompanive të cilat operojnë me këtë sistem. Çdo herë në nënstacionet elektrike janë të nevojshme të bëhen matje, mbikëqyrje, kontrollë, operime dhe funksione mbrojtëse me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Integrimi i sistemeve të automatizimit, ndryshimet në rrjetin ekzistues elektrik, instalimi i pajisjeve të reja, përdorimi i makinerive janë vetëm disa prej investimeve të parapara në pesë vjeçarin e ardhshëm.

Investimet e tilla i ofrojnë OSSH-së mundësinë për të optimizuar funksionimin e sistemit elektrik të shpërndarjes dhe për të përmirësuar drejtpërdrejtë parametrat e besueshmërisë. Sigurisht se integrimi i

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 32 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

sistemeve dhe elementeve të reja në sistemin shpërndarës kërkon që rrjetet ekzistuese të rikonfigurohen në mënyrë që një integrim i tillë të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Projektet do të kategorizohen si më poshtë:

*Tabela 16. Projektet e propozuara për periudhën 2026-2030.*

| Nr. | Emri i projektit                                               | Emri i Programit                                 |
|-----|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| 1   | Ndërrimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë            | Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit |
| 2   | Renovimi i nënstacioneve - Kthinat e reja                      | Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit |
| 3   | Automjeti për testim të transformatorëve                       | Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit |
| 4   | Riinstalimi i tokëzimit mbrojtës dhe rrufepritësit             | Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit |
| 5   | Efiçienca e energjisë në nënstacionet e OSSH-së                | Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit |
| 6   | Ndërrimi i releve në nënstacione                               | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 7   | Ndërrimi i releve në stabilimente                              | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 8   | Instalimi i ndarësve automatik                                 | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 9   | Instalimi i Detektorëve Tregues të Defekteve (FID)             | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 10  | Instalimi i Rimbyllësve Automatik                              | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 11  | Instalimi i Seksionalizatorëve                                 | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 12  | Pajisje për testim                                             | Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve     |
| 13  | Instalimi i sistemit SCADA në stabilimente                     | Rrjetat e Mençura                                |
| 14  | Përditësimi, Implementimi dhe Projektimi Inxhinierik i SCADA-s | Rrjetat e Mençura                                |
| 15  | Dalje të mencura (PP – Full Smart Feeder)                      | Rrjetat e Mençura                                |
| 16  | Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS)                       | Rrjetat e Mençura                                |
| 17  | Sistemi i Menaxhimit të Ndërprerjeve (OMS)                     | Rrjetat e Mençura                                |
| 18  | Monitorimi i rrjetit TU                                        | Rrjetat e Mençura                                |

Për shkak të situatave të ndryshme që mund të paraqiten dhe mbi të gjitha duke u bazuar në varësinë mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë në zbatimin e projekteve mund të themi që koha, shpenzimet e parashikuara dhe mënyra e zbatimit të këtyre projekteve mund të konsiderohet si subjekt i ndryshimeve të mundshme.

Në pjesët e mëposhtme do të paraqitet një përshkrim më i detajuar i projekteve investive të parashikuara për t'u zbatuar gjatë pesë viteve të ardhshme, duke përfshirë përshkrimin e shkurtër të projekteve, qëllimin e tyre, koston e përgjithshme dhe përfitimet e pritshme nga realizimi i këtyre projekteve.

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 33 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

#### 4.10.1 Rinovimi i NS, Mirëmbajtja dhe Cilësia e Rrjetit

**Ndërrimi dhe instalimi i transformatorëve të fuqisë:** Transformatorët e fuqisë janë komponentë komplekse me nënkomponente të shumta që mund të keqfunksionojnë në mënyra të ndryshme. Prandaj, probabiliteti i një avarie apo defekti që mund të ndodhin në transformator përcaktohet nga faktorë të shumtë, duke përfshirë jetëgjatësinë dhe gjendjen teknike të transformatorit.

OSSH gjatë vitit të fundit ka vazhduar me ndërrimin e transformatorëve të fuqisë problematik dhe instalimin e transformatorëve tërësisht të rinj. Mirëpo ekziston ende një numër i caktuar i transformatorëve të fuqisë të vendosur në nënstacionet elektrike në Kosovë që janë të vjetër dhe kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë për të operuar që është gjithashtu kohëzgjatja për të cilën transformatorët janë projektuar zakonisht për të funksionuar.

Duke e ditur se transformatori i fuqisë është njëri nga elementet kryesor të rrjetit elektrik atëherë rëndësia që duhet kushtuar sa i përket mirëmbajtjes së tyre, inspektimit, ndërrimit dhe instalimit të tyre duhet të jetë mjaft e lartë.

Ndërrimi i transformatorëve do të bëhet duke u bazuar në disa faktorë të ndryshëm:

- Jetëgjatësia e transformatorëve
- Rezultatet e dobëta të testimeve
- Mbingarkesa e transformatorëve
- Gjendja e transformatorëve

Ndarja e transformatorëve të paraparë për ndërrim sipas fuqisë së instaluar është sipas tabelës së paraqitur më poshtë:

*Tabela 17. Ndërrimi dhe shtimi i transformatorëve të fuqisë gjatë periudhës 2026 - 2030.*

| Nr.   | Niveli i tensionit | S [MVA] | Numri i Transformatorëve |
|-------|--------------------|---------|--------------------------|
| 1     | 35/10(20) kV       | 4       | 1                        |
| 2     |                    | 8       | 19                       |
| 3     | 10/20 kV           | 8       | 2                        |
| Total |                    |         | 22                       |

*Tabela 18. Lista e transformatorëve të planifikuar për ndërrim gjatë periudhës 2026 - 2030.*

| No. | Distrikti | Nënstacioni                | TR Nr. | Sn [MVA] | Viti |
|-----|-----------|----------------------------|--------|----------|------|
| 1   | DPR       | Prishtina I 35/10 [kV]     | T2     | 8        | 2027 |
| 2   | DPR       | Fushe Kosova II 35/20 [kV] | T1     | 8        | 2027 |
| 3   | DPR       | Fushe Kosova II 35/20 [kV] | T2     | 8        | 2027 |
| 4   | DPR       | Mazgit 35/10 [kV]          | T1     | 8        | 2027 |

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 34 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

|    |     |                         |    |       |      |
|----|-----|-------------------------|----|-------|------|
| 5  | DGL | Gjilani I 35/10 [kV]    | T1 | 8     | 2027 |
| 6  | DGL | Klllokot 35/10 [kV]     | T2 | 8     | 2027 |
| 7  | DGL | Vitia 110/35/10 [kV]    | T4 | 8     | 2027 |
| 8  | DFE | Ferizaj III 35/10 [kV]  | T4 | 8     | 2027 |
| 9  | DMI | Vushtrri I 35/20 [kV]   | T  | 8     | 2027 |
| 10 | DMI | Vushtrri I 35/20 [kV]   | T  | 8     | 2027 |
| 11 | DPR | Mazgiti 35/10 [kV]      | T  | 8     | 2027 |
| 12 | DPR | Badovci 35/10 [kV]      | T  | 8     | 2027 |
| 13 | DPZ | Dragash 35/10 [kV]      | T  | 8     | 2027 |
| 14 | DPR | Besia 35/10 [kV]        | T1 | 4 (8) | 2028 |
| 15 | DPZ | Prizreni III 35/10 [kV] | T1 | 8     | 2028 |
| 16 | DPZ | Prizreni III 35/10 [kV] | T2 | 8     | 2028 |
| 17 | DPZ | Prizreni IV 35/10 [kV]  | T2 | 8     | 2028 |
| 18 | DFE | Ferizaj II 35/10 [kV]   | T4 | 8     | 2028 |
| 19 | DFE | Shtërpca 35/10 [kV]     | T1 | 8     | 2028 |
| 20 | DGJ | Gjakova III 35/10 [kV]  | T1 | 8     | 2028 |
| 21 | DPE | Istogu 110/10 [kV]      | T  | 8     | 2028 |
| 22 | DPE | Gurakovci 35/10 [kV]    | T  | 8     | 2028 |

Arsyet se pse duhet të bëhet ndërrimi i transformatorëve të fuqisë janë:

- Besueshmëria e përmirësuar - Transformatorët e vjetër të cilët kanë një kohë të gjatë në operim shpesh dijnë të përballen me probleme të ndryshme nga lidhjet e lira, izolimi i degraduar dhe vaji. Kjo mund të çojë në probleme të cilësisë së energjisë dhe probleme të tjera. Poashtu, transformatorët të cilët kanë devijime në vlerat e testimit zvogëlojnë sigurinë e furnizimit me energji elektrike.
- Shpenzime të ulëta të mirëmbajtjes - Transformatorët e vjetër janë më të prirur të kenë nevojë për ndryshime të vajit, rrezik të shtuar të dështimit të komponentëve dhe rrjedhje për shkak të vjetërsisë së diktungave të transformatorëve.

#### Renovimi i nënstacioneve:

Tabela 19. Ndërrimi dhe shtimi i kthinave në Nënstacione.

| Nr. | Viti | Distrikti | Nënstacioni            | Nr. i kthinave | 35 [kV] | 24 [kV] |
|-----|------|-----------|------------------------|----------------|---------|---------|
| 1   | 2026 | DPE       | Istogu 110/10 [kV]     | 3              | 0       | 3       |
| 2   | 2026 | DPE       | Gurakovci 35/10 [kV]   | 3              | 0       | 3       |
| 3   | 2026 | DFE       | Lipjani 110/35/10 [kV] | 32             | 0       | 32      |
| 4   | 2027 | DMI       | Vushtrri I 35/20 [kV]  | 12             | 4       | 8       |
| 5   | 2027 | DPR       | Mazgiti 35/10 [kV]     | 3              | 0       | 3       |
| 6   | 2027 | DPZ       | Theranda 110/10 [kV]   | 3              | 0       | 3       |
| 7   | 2027 | DPR       | Badovci 35/10 kV       | 2              | 1       | 1       |
| 8   | 2027 | DPE       | Peja 1 110/35/10 [kV]  | 1              | 0       | 1       |

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 35 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

|    |      |     |                            |                                                            |
|----|------|-----|----------------------------|------------------------------------------------------------|
| 9  | 2028 | DPR | Mazgiti 35/10 [kV]         | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 10 | 2028 | DPZ | Prizreni 3 110/10 [kV]     | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 11 | 2028 | DFE | Hani i Elezit 110/6 [kV]   | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 12 | 2028 | DGJ | Malisheva 35/10 [kV]       | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 13 | 2029 | DPR | Drenasi 220/10 [kV]        | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 14 | 2029 | DPE | Gurakoci 35/10 [kV]        | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 15 | 2029 | DPZ | Theranda 110/10 [kV]       | Të gjitha kthinat në nënstacion (ato të sistemit të hapur) |
| 16 | 2029 | DPR | Prishtina 1 110/35/10 [kV] | Ana 35 [kV] e nënstacionit                                 |
| 17 | 2029 | DPE | Klina 10 [kV]              | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 18 | 2029 | DPZ | Prizreni IV 35/10 [kV]     | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 19 | 2029 | DGL | Vitia 110/35/10 [kV]       | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 20 | 2029 | DGL | Artana 35/10 [kV]          | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 21 | 2030 | DPZ | Dikanca 35/10 [kV]         | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 22 | 2030 | DFE | Shterpca 35/10 [kV]        | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 23 | 2030 | DGJ | Gjakova 2 110/10 [kV]      | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 24 | 2030 | DPR | Badovci 35/10 [kV]         | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 25 | 2030 | DPR | Batlava 35/10 [kV]         | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 26 | 2030 | DPE | Deçani 110/10 [kV]         | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |
| 27 | 2030 | DPZ | Dragashi 35/10 [kV]        | Të gjitha kthinat në nënstacion                            |

**Automjeti për testim të transformatorëve:** Gjatë vitit 2028 OSSh planifikon të pajisjet me një automjet të rëndësishëm i cili do të shërbej dhe ndihmoj në testimin e transformatorëve. Për të përmirësuar vlerësimin e gjendjes së transformatorëve në teren automjeti për testimin e transformatorëve është i pajisur me një përzgjedhje të instrumenteve testuese sipas standardeve evropiane. Ky automjet do t'i shërbej OSSh-së si mënyrë shumë më e lehtë e testimit dhe ruajtjes së të dhënave si dhe siguri më e lartë e testimit. Automjeti i testimit të transformatorëve kursen kohën dhe lehtëson procesin e testimit të transformatorëve duke kursyer ngjitjet në transformator dhe ndërrimin e lidhjeve në bazë të llojit të testimit.

Automjeti për testimin e transformatorëve do të përfshij këto lloje të testimeve:

- Testimi i izolimit
- Testimi i rezistencës së pëstjelljeve
- Testimi i herësit të transformimit dhe verifikimi i grupit vektorial
- Faktori i fuqisë/shpërndarjes për transformator dhe izolator
- Analizë e vlerave të frekuencës
- Testimi i tensionit të aplikuar deri 70 [kV]

**Riinstalimi i tokëzimit mbrojtës dhe rrufepritësit:** Rrymat e defektit-prishjeve pranë objekteve të shpërndarjes së energjisë mund të jenë shumë të larta. Kjo mund të rezultojë në tensione të rrezikshme të hapit dhe kontaktit-prekjes.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 36 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

OSSH gjatë vitit 2029 parasheh që tokëzimi mbrojtës duhet të ri-instalohet në ato nënstacione të KEDS-it që i ka përfunduar jetëgjatësia e tokëzimit mbrojtës ose janë në kushte shumë të këqija. **Planifikohet që në të gjitha 39 nënstacionet e OSSH-së, 80% e nënstacionit të ketë një tokëzim të ri mbrojtës.** Tokëzimi duhet të vendoset në të gjitha pajisjet, rrethojat, dyert, dritaret dhe të gjitha pjesët metalike të nënstacionit. Poashtu rrufepritësi duhet të ndërrohet në të gjitha nënstacionet. Të gjitha këto ndryshime duhet të përcillen me testime adekuate për të kontrolluar nëse parametrat janë brenda standardeve IEC.

Karakteristikat kryesore për tokëzimin mbrojtës të riinstaluar përfshijnë:

- ✓ Zvogëlimi i tensionit të hapit
- ✓ Zvogëlimi i tensionit të kontaktit
- ✓ Rritja e sigurisë për personelin që punon në nënstacion
- ✓ Zvogëlimi i keqfunksionimeve të pajisjeve për shkak të rrufeve ose problemeve me tokëzimin

*Tabela 20. Riinstalimi i tokëzimit mbrojtës dhe rrufepritësit.*

| No. | District  | Substation                  |
|-----|-----------|-----------------------------|
| 1   | Prishtina | Prishtina I 35/20 [kV]      |
| 2   | Prishtina | Fushë Kosova 35/10(20) [kV] |
| 3   | Prishtina | Fushë Kosova II 35/20 [kV]  |
| 4   | Prishtina | Parku i Biznesit 35/10 [kV] |
| 5   | Prishtina | Mazgiti 35/10(20) [kV]      |
| 6   | Prishtina | Koliqi 35/10 [kV]           |
| 7   | Prishtina | Badovci 35/10 [kV]          |
| 8   | Prishtina | Batlava 35/10 [kV]          |
| 9   | Prishtina | Besia 35/10 [kV]            |
| 10  | Mitrovica | Shupkovci 10 [kV]           |
| 11  | Peja      | Peja II 35/10 [kV]          |
| 12  | Peja      | Gurakoci 35/10 [kV]         |
| 13  | Peja      | Isniq 35/10 [kV]            |
| 14  | Peja      | Klina 10 [kV]               |
| 15  | Peja      | Kfori 35/10 [kV]            |
| 16  | Prizreni  | Prizreni III 35/10 [kV]     |
| 17  | Prizreni  | Prizreni IV 35/10 [kV]      |
| 18  | Prizreni  | Dragashi 35/10 [kV]         |
| 19  | Prizreni  | Dikanca 35/10 [kV]          |
| 20  | Prizreni  | Pirana 35/10 [kV]           |
| 21  | Prizreni  | Zhuri 35/10 [kV]            |
| 22  | Ferizaj   | Ferizaj II 35/10 [kV]       |
| 23  | Ferizaj   | Ferizaj III 35/10 [kV]      |
| 24  | Ferizaj   | Kaçaniku 35/10 [kV]         |
| 25  | Ferizaj   | Kaçaniku II 35/10 [kV]      |
| 26  | Ferizaj   | Magure 35/10 [kV]           |
| 27  | Ferizaj   | Shtërpca 35/10 [kV]         |
| 28  | Ferizaj   | Shtime 35/10 [kV]           |
| 29  | Gjilan    | Gjilani I 35/10 [kV]        |
| 30  | Gjilan    | Gjilani II 35/10 [kV]       |

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 37 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

|    |         |                        |
|----|---------|------------------------|
| 31 | Gjilan  | Gjilani IV 35/10 [kV]  |
| 32 | Gjilan  | Kllokot 35/10 [kV]     |
| 33 | Gjilan  | Lladova 35/10 [kV]     |
| 34 | Gjilan  | Artana 35/10 [kV]      |
| 35 | Gjakova | Gjakova I 35/10 [kV]   |
| 36 | Gjakova | Gjakova II 10 [kV]     |
| 37 | Gjakova | Gjakova III 35/10 [kV] |
| 38 | Gjakova | Malisheva 35/10 [kV]   |
| 39 | Gjakova | Xërxa 35/10 [kV]       |

**Efiçienca e energjisë në nënstacionet e OSSH-së:** Duke pasur parasysh ndërgjegjësimin për klimën dhe mjedisin dhe zhvillimin e burimeve të ripërtitshme OSSH parasheh që të filloj me projektin për efiçiençën e energjisë në nënstacionet të cilat janë në pronësi të tij.

Shpenzimet e energjisë elektrike në nënstacionet e OSSH-së realizohen përmes transformatorëve shtëpiak 10(20)/0.4 [kV] dhe kryesisht përfshijnë:

- Furnizimin e pajisjeve të instaluar në nënstacion
- Ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm të nënstacionit
- Ngrohje dhe klimatizim për pajisjet dhe për ekipet të cilat përdorin nënstacionet si pika të qëndrimit për kujdestari.

Në mënyrë që të mbulohet ky shpenzim, OSSH parasheh instalimin e paneleve fotovoltaike (solare) në kulmet e objekteve të nënstacioneve. Instalimi i paneleve solare do të varet nga disa faktorë që kryesisht kanë të bëjnë me madhësinë e objekteve të nënstacioneve, izolimin e nënstacionit dhe numrin e elementeve të instaluar në nënstacion të cilat kërkojnë furnizim. Një projekt i tillë më shumë do të shërbej për: reduktimin e emetimit të CO<sub>2</sub>, reduktimin e kostove të energjisë të shpenzuar në nënstacionet e OSSH dhe përmbushjen e objektivave të strategjive të ndryshme të energjisë.

#### **4.10.2 Mbrojtja e rrjetit dhe menaxhimi i defekteve**

**Ndërrimi i releve në nënstacione:** Zhvillimi i teknologjive të reja ka prekur të gjitha fushat e sistemit elektroenergjetik duke përsheptuar zhvillimin e pajisjeve të reja në fushën e kontrollit, monitorimit dhe mbrojtjes. Në përputhje me këtë zhvillim, është e rëndësishme që në sistemin shpërndarës të përdoren pajisjet e duhura për të arritur stabilitetin dhe funksionimin e duhur të këtij sistemi. Një nga pjesët më të rëndësishme të sistemit shpërndarës është pjesa e sistemit të mbrojtjes sepse është shumë e rëndësishme që sistemi të mbrohet nga defektet e ndryshme që mund të ndodhin. Në sistemin e mbrojtjes, një rele mbrojtëse është një pajisje mbrojtëse e krijuar për të shkyçur një ndërprerës atëherë kur zbulohet një defekt apo avari.

Nevoja për të vepruar shpejt për të mbrojtur qarqet dhe pajisjet zakonisht kërkon që reletë mbrojtëse të përgjigjen dhe të shkyçin një ndërprerës brenda milisekondave. Dizajni dhe prodhimi i releve mbrojtëse kanë arritur në një nivel të ri avancimi ku reletë numerike janë shfaqur së fundmi me funksione të ndryshme dhe me opsione të ndryshme rregullimi.

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 38 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

Kërkesat themelore të mbrojtjeve të sistemit të shpërndarjes janë:

- Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit
- Për të minimizuar dëmtimet dhe kostot e riparimit
- Për të garantuar sigurinë e personelit

Në sistemin shpërndarës të Kosovës në nivelin e tensionit të mesëm 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV] ekziston një numër i madh i releve mbrojtëse të vendosura në dalje furnizuese, ardhje apo trafo fusha me qëllim të mbrojtjes nga lidhjet e shkurta apo mbingarkesat.

Përqindja më e madhe e releve të vendosura në nënstacione kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë të tyre të operimit dhe duke e ditur natyrën kritike dhe të ndjeshme të kësaj pajisje atëherë OSSH që ndërrimin e releve t'a filloj nga viti 2024 dhe të vazhdoj me ndërrimin e tyre edhe gjatë periudhës 2026-2030 (numri i të cilave do të paraqitet në tabelat më poshtë).

Arsyet se pse OSSH parasheh që të bëhet ndërrimi i releve janë:

- Reletë ekzistuese kanë tejkaluar jetëgjatësinë e paraparë për operim
- Aftësitë teknike të releve janë duke u zvogëluar krahas operimit të tyre
- Reletë ekzistuese të cilat janë propozuar për ndërrim janë rele jo të drejtuara. Reletë ekzistuese mund të reagojnë si shkak i lidhjeve të shkurta të cilat mund të ndodhin në daljet tjera. Ndërsa reletë të cilat parashihen të blihen do të jenë rele të drejtuara të cilat do të reagojnë apo do të detektojnë defektin apo lidhjet e shkurta vetëm në një drejtim dhe nuk do të reagojnë atëherë kur defekti është në drejtim tjetër.
- Në reletë ekzistuese mundësia e rregullimit të parametrave të mbrojtjes rele për lidhjet e shkurta me tokë në rele është  $0.1 \times I_n$ , që paraqet një disavantazh shumë të madh për parametrizimin dhe mbrojtjen e mirëfilltë.
- Për të shmangur ndërprerjet e padëshiruara (jo selektive) OSSH është detyruar që në reletë ekzistuese të kaloj mbrojtjen për lidhje të shkurtë me tokë në linjat 10 [kV] si IDMT (Inverse Definite Minimum Time) brenda kufirit minimal të lejuar të releut  $0.1 \times I_n$ , IEC N. Inverse,  $T_M = 0.1$  (në NS të OST) dhe  $0.05$  (në NS të OSSH).
- Reletë ekzistuese përfshijnë më pak funksione të mbrojtjes se sa reletë e propozuara për ndërrim.
- Kufiri i mbrojtjes për lidhje të shkurtë me tokë nuk mundëson që të ketë selektivitet real me rrjetet 35 [kV] dhe me mbrojtjet e vetë OST.

Numri i releve të parapara për ndërrim gjatë viteve 2026-2027 është sipas tabelës së mëposhtme:

*Tabela 21. Ndërrimi i releve mbrojtëse.*

| Nr.    | Viti | Sasia |
|--------|------|-------|
| 2      | 2026 | 200   |
| 3      | 2027 | 172   |
| Totali |      | 372   |

**Pra gjatë kësaj periudhe do të ndërrohen gjithsej 372 rele mbrojtëse në nënstacionet kryesore.**

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 39 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Përfitimet të cilat do të vijnë pas ndërrimit të mbrojtjeve rele në nënstacionet kryesore janë të shumta, mirëpo vlen të përmenden këto përfitime:

- Do të rritet siguria e sistemit të shpërndarjes
- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve apo rënieve të padëshiruara në linjat 35 [kV], 20 [kV], 10 [kV] dhe 6 [kV]
- Do të zvogëlohet numri i ndërprerjeve të padëshiruara të linjave të “shëndetshme”
- Ulja e kostos dhe rritja e cilësisë së energjisë
- Mundësia e rregullimit, parametrizimit të mbrojtjeve rele do të jetë më e madhe
- Përdorimi i një numri më të madh të funksioneve të mbrojtjeve rele
- Do të rritet selektiviteti ndërmjet releve në kufirin OSSh dhe OST

**Ndërrimi i releve në stabilimente:** Një pikë tjetër mjaft e rëndësishme e rrjetit të shpërndarjes, janë edhe stabilimentet apo nënstacionet dytësore që paraqesin pikat ku zakonisht bëhet ndarja e daljes në degëzime për qëllime të ndryshme e më kryesorja për izolimin e prishjeve-defekteve vetëm në zonën ku ka ndodhur prishja apo defekti. Përderisa këto nënstacione dytësore në të kaluarën ishin kryesisht instalime pasive me një transformator, siguresa si dhe elemente të tjera që operonin me dorë, pajisje të ndryshme të avancuara tashmë veçse janë pjesë përbërëse të tyre. Në rrjetin shpërndarës ka një numër të madh të stabilimenteve shpërndarëse 10(20)/0.4 [kV] të vendosura në pika të ndryshme të daljeve 10 apo 20 [kV]. Daljet apo degëzimet e këtyre stabilimenteve shpërndarëse janë të pajisura me mbrojtje rele në mënyrë që sistemi të mbrohet nga defektet e ndryshme që mund të ndodhin. Për stabilimentet 10(20)/0.4 [kV] më kritike është paraparë që gjatë fundit të periudhës 2026-2030 të bëhet ndërrimi i releve për të shmangur ndërprerjet e padëshiruara (jo selektive), për mundësi të lidhjes me GOOSE System, për të rritur selektivitetin mes releve në stabiliment dhe daljeve 10 apo 20 [kV].

**Instalimi i ndarësve automatik:** Produktet për montim të jashtëm janë komponentë thelbësorë të rrjeteve të shpërndarjes së tensionit të mesëm. Ndarësit me motor kanë për qëllim të kryejnë operacione të kycjes/shkycjes të kontrolluar nga distanca. Ato ofrojnë gjithashtu funksionim manual lokal me dorezë të për të siguruar izolim të sigurt në qark gjatë mirëmbajtjes ose rregullimeve të defekteve.

Karakteristikat kryesore të ndarësve me motor të komanduar nga distanca janë:

- Integrimi në SCADA
- Garantim i sigurisë së furnizimit
- Reduktimi i SAIDI-SAIFI
- Lokalizimi i shpejtë i defekteve

OSSH gjatë vitit 2029 planifikon të filloj me instalimin e ndarësve me motor të komanduar nga distanca në linjat ajrore shumë të gjata, me një numër të madh konsumatorësh dhe me shumë defekte. Ato do të instalohen në zona të ndryshme dhe në vende të vështira për t'u arritur dhe një instalim i tillë do të lehtësojë punën e ekipeve të rrjetit për të lokalizuar defektin dhe për të reduktuar SAIDI-SAIFI.

**Instalimi i Detektorëve Tregues të Defekteve (FID):** Duke qenë se sistemi elektrik i shpërndarjes është një sistem më i ndërlikuar dhe duke e ditur se elementet e këtij sistemi janë të shpërndara nëpër shumë pika qofshin ato të hapura apo të mbyllura mund të themi se sistemi i shpërndarjes është vazhdimisht i ekspozuar

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 40 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

ndaj dukurive të defekteve për arsye të ndryshme, si goditja e rrufesë, dështimi i pajisjeve, kushtet e këqija atmosferike etj.

Të gjitha dukuritë të cilat shkaktojnë prishje apo dështime të rrjetit të shpërndarjes ndikojnë në besueshmërinë e sistemit dhe rezultojnë në riparime ndonjëherë të shtrenjta, humbje të produktivitetit dhe humbje të energjisë për klientët. Meqenëse defekti është i paparashikueshëm, kërkohet një vendndodhje dhe izolim i shpejtë i defektit për të minimizuar ndikimin e këtyre defekteve në sistemet e shpërndarjes. Në shumicën e këtyre prishjeve janë ekipet e rrjetit dhe mirëmbajtjes ato që kanë punën më të madhe për t'i eliminuar këto prishje apo defekte dhe për të rikthyer më pas furnizimin me energji elektrike për konsumatorë. Mirëpo tendenca e OSSH-së është që të përdorë pajisje dhe metoda të ndryshme për të lokalizuar defektet e ndryshme që ndodhin në rrjet. Një nga këto pajisje janë edhe detektorët tregues të prishjeve (defekteve).

Tre treguesit e instaluar për secilën fazë përfaqësojnë një pajisje elektronike të krijuar për linjat ajrore të tensionit të mesëm, e cila monitoron vazhdimisht linjën ajrore dhe i jep vlerat e matura dhe informacionin e defekteve në Qendrën e Kontrollit Kryesor - SCADA. Ky informacion merret nga terreni sepse aty është i instaluar edhe paneli i komunikimit SCADA me elementët shoqërues.

Treguesit e instaluar vendosen në një pozicion strategjik përgjatë linjës në mënyrë të tillë që të informojnë ekipet e terrenit se në cilën pjesë të linjës është avaria, para ose pas vendndodhjes ku janë instaluar treguesit. Në momentin që ndodh një avari në linjën 35 [kV] Prizren 1 - Zhur, treguesit do të monitorojnë rrymat e regjistruara dhe në varësi të defektit do të gjenerohet një dritë specifike vezulluese (LED). Nëse defekti ka ndodhur ndërmjet nënstacionit të furnizimit dhe vendit ku janë vendosur treguesit atëherë do të nënkuptohet se defekti ka ndodhur në atë pjesë.

FID-i i parë është instaluar gjatë vitit 2021 në linjën ajrore 35 [kV] Prizren 1 – Zhur dhe është e rëndësishme të përmendet se ky FID mund të monitorohet nga sistemi ekzistues SCADA. Gjatë vitit 2023 KEDS ka instaluar FID në këta largpërçues: Prishtina 1-Badovci, Podujeva- Koliqi, Kosova A-Fushë Kosova, Kosova A-Mazgiti, Peja-Gurakoci, Ferizaji 1-Shtërpca, Ferizaji 1-Kaçaniku, Lipjani-Magure, Lipjani-Shtime, Gjilani 1-Artana dhe Rahoveci-Malisheva. Poashtu edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar instalimi i FID në largpërçues të ndryshëm.

Instalimi i detektorëve tregues të defekteve do të bëhet në dy faza:

- Deri në fund të vitit 2027 do të bëhet instalimi i FID-ve në linjat ajrore 35 [kV] të sistemit të shpërndarjes
- Ndërsa gjatë viteve 2028 e tutje do të bëhet instalimi i FID-ve në linjat ajrore 10 [kV] të sistemit të shpërndarjes (pikat problematike)

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e FID-ve që do të instalohen gjatë viteve 2026-2030:

*Tabela 22. Instalimi i FID gjatë viteve 2026-2030.*

| Viti         | Nr. i FID-ve |
|--------------|--------------|
| 2026         | 6            |
| 2028         | 22           |
| 2029         | 28           |
| 2030         | 25           |
| <b>Total</b> | <b>81</b>    |

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 41 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Përdorimi i treguesve të tillë do të zvogëlojë kohën e gjetjes së avarive në minimumin absolut. Përfitimet kryesore të instalimit të këtyre FID-ve janë reduktimi i ndjeshëm i kohëzgjatjes së ndërprerjeve të energjisë (SAIDI) dhe se ekipet shpenzojnë më pak kohë për të kërkuar vendndodhjen e defektit dhe janë në gjendje të izolojnë dhe riparojnë më shpejt seksionet me defekte, duke rezultuar gjithashtu në rritje kursimet e kostos.

**Instalimi i Rimbyllësve Automatik:** Rimbyllësi automatik është një lloj pajisje komutuese inteligjente e përdorur në automatizimin e rrjetit të shpërndarjes. Mund të zbulojë rrymën e defektit (lidhjeve të shkurta), të shkyç qarkun brenda një kohe të caktuar dhe të kryejë një numër të caktuar rimbylljesh.

Në vitet 2022-2023, OSSH ka instaluar rimbyllësin (kyçësin) e parë në rrjetin e shpërndarjes. Ky rimbyllës automatik është instaluar në LP 10(20) [kV] Strezovci të NS 110/10 [kV] Kamenica, LP ky që përballet me defekte (avari) të shpeshta dhe që shtrihet në zona jo të përshtatshme. Kjo pajisje lejon që furnizimi të rikthehet automatikisht, pas vetëm një ose dy luhatjesh. Rimbyllësi automatik që do të instalohet do t'i kursejë kompanisë kohë dhe shpenzime të konsiderueshme. Ndërsa për ndërprerjet që kërkojnë një ekipë që do të merret me rregullim e avarive, rimbyllësit minimizojnë zonën e ndërprerjes dhe ndihmojnë ekipet të lokalizojnë shpejt problemin dhe të rikthejnë furnizimin me energji elektrike.

Për sa i përket karakteristikave të mbrojtjes dhe kontrollit, kjo pajisje mund të arrij zbulimin e defekteve, të gjykojë natyrën e rrymës, të kryejë funksione komutuese, të ketë funksione automatike dhe funksione të kontrollit të mbrojtjes, pa pajisje shtesë funksionimi. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e rimbyllësve automatik që do të instalohen gjatë viteve 2026-2030:

*Tabela 23. Instalimi i rimbyllësve automatik.*

| Nr.    | Viti | Numri i rimbyllësve |
|--------|------|---------------------|
| 1      | 2026 | 10                  |
| 2      | 2027 | 1                   |
| 3      | 2028 | 8                   |
| 4      | 2029 | 8                   |
| 5      | 2030 | 8                   |
| Totali |      | 35                  |

**Instalimi i Seksionalizatorëve:** Një seksionalizator është një pajisje mbrojtëse që vendoset në rrjetet ajrore të shpërndarjes për të izoluar seksionet me defekt pas detektimit të ndërprerjes së tensionit ose rrymës si rezultat i funksionimit të një pajisjeje mbrojtëse më lart në rrjet.

Për dallim nga rimbyllësi automatik, seksionalizatorët nuk e ndërpresin rrymën e defektit, por punojnë në koordinim me to për të identifikuar dhe izoluar seksionin me defekt pasi të jetë ndërprerë rryma nga rimbyllësi automatik. Përfitimet kryesore nga instalimi i seksionalizatorëve janë:

- Izolim më i mirë i defekteve: Lejon identifikimin dhe izolimin e saktë të segmentit me defekt, pa ndikuar pjesët e shëndetshme të rrjetit.
- Reduktim i zonës së ndërprerjes: Ndikon më pak konsumatorë

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 42 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

- Koordinim me autorecloser: Funksionon pas ndërprerjes së rrymës, duke lejuar rimbyllësin automatik të rikthejë furnizimin në pjesët pa defekt.
- Funksionim automatik: Rrit automatizimin e rrjetit dhe zvogëlon ndërhyrjet manuale.
- Mbështet sistemin FLISR: Thelbësor për sistemet inteligjente të lokacionit të Defekteve, izolimit dhe rikthimit të furnizimit.
- Kosto-efektiv: Redukton ngarkesën ndaj pajisjeve mbrojtëse lart në rrjet dhe shmang ndërprerjet e panevojshme.

Seksionalizatorët do të vendosen në mënyrë strategjike në daljet e tensionit të mesëm në linjat të cilat kanë degëzime të shumta veçanërisht në:

- Pikat e mesme të daljeve midis grupeve të ngarkesës
- Degëzimet në T që furnizojnë zona të ndryshme
- Zona të gjata të daljeve ose zona me defekte të shpeshta

Seksionalizatorët të cilët do të instalohen do të jenë të ‘mencur’ (me komunikim) dhe do të dërgojnë të dhëna për statusin (hapur/mbyllur/defekt) tek rikyqësi automatik pranë tij.

Kriteret kryesore për përzgjedhjen e vendosjes së seksionalizatorëve do të jenë:

- Topologjia e daljeve
- Historia e prishjeve (defekteve) në segmente të ndryshme të linjave
- Profili i ngarkesës
- Skemat ekzistuese të mbrojtjes
- Infrastruktura e komunikimit e disponueshme
- Përputhshmëria me rikyqësit automatik (në parametra dhe protokolle)

Gjatë vitit 2026 OSSH synon që të instaloj 10 pajisje të tilla në rrjetin shpërndarës. Vendosja e seksionalizatorëve në rrjetin shpërndarës përmirëson ndjeshëm menaxhimin e defekteve duke mundur izolim të targetuar, rikthim më të shpejtë të energjisë dhe koordinim të saktë me autoreklozerët. Pajisjet si kjo janë elementë kyç në drejtim të rrjeteve të mençura dhe në rritjen e besueshmërisë së rrjetit elektrik.

*Tabela 24. Instalimi i Seksionalizatorëve.*

| Nr.    | Viti | Nr. Seksionalizatorëve |
|--------|------|------------------------|
| 1      | 2026 | 10                     |
| 2      | 2027 | 10                     |
| 3      | 2028 | 16                     |
| 4      | 2029 | 16                     |
| 5      | 2030 | 16                     |
| Totali |      | 68                     |

**Pajisje për testim:** Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), në kuadër të strategjisë së tij për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, rritjen e efikasitetit operativ dhe përmirësimin

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 43 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

e sigurisë teknike të infrastrukturës, synon të investojë në blerjen e pajisjeve të specializuara dhe të teknologjisë së avancuar të domosdoshme për funksionimin e disa proceseve operative dhe të mirëmbajtjes. Këto pajisje janë të domosdoshme për të mbështetur aktivitetet ditore të mirëmbajtjes dhe operimit të rrjetit, si dhe për të mundur një menaxhim proaktiv dhe parandalues të aseteve kritike të sistemit. Investimet e planifikuara përfshijnë pajisje për monitorim dhe analizë të avancuar të transformatorëve të fuqisë, pajisje mbrojtëse për ndalimin e rrymave të shkurtër, si dhe teknologji ajrore për inspektim inteligjent të rrjetit përmes dronëve. Disa nga pajisjet të cilat parashihen të blihen në periudhën 2026-2030 janë:

1. LIDAR për Vintra Drone
2. Is-limiter (për lidhje të shkurtëra në rrjet)
3. DGA për transformatorë të fuqisë
4. Pajisja e Testimit të Reaktancës së Transformatorit
5. SF6 – Analizator i Gazit
6. Pajisje për testim të zbarrave
7. Pajisje për testim në primar

Disa nga përparësitë e përdorimit të këtyre pajisjeve janë:

- ❖ Inspektim ajror të linjave dhe trasesë së rrjetit TM/TU me saktësi të lartë, sidomos në terrene të paarrtshme ose të vështira për ekipet në terren.
- ❖ Reduktimin e ndikimit të rrymave të lidhjeve të shkurtëra në transformatorë, kablllo dhe pajisje ndërlidhëse, duke zgjatur jetëgjatësinë e tyre.
- ❖ Lejon detektimin në kohë të defekteve të brendshme, si rritje temperature, shkarkime elektrike ose degradim i izolimit.
- ❖ Detekton defekte të fshehura në izolime të dëmtuara apo lidhje të lirshme, që nuk mund të vërehen përmes testimeve të zakonshme.

#### **4.10.3 Rrjetat e Mençura**

**Instalimi i sistemit SCADA në stabilimente:** OSSh ka synimin të rrisë besueshmërinë dhe të zvogëloj kohën e ndërprerjeve sa i përket furnizimit me energji elektrike. Për të arritur këto objektiva, ekzistojnë mundësi të ndryshme prej të cilave mund të specifikohet instalimi i sistemit SCADA në stabilimente apo nënstacione sekondare.

Sistemet e sotme SCADA në përgjigje të ndryshimit të nevojave të biznesit, kanë shtuar funksione të reja dhe janë ndihmë për avancime strategjike drejt rrjeteve inteligjente. Një sistem modern SCADA është gjithashtu një investim strategjik i cili është investim i domosdoshëm për të gjitha kompanitë e shpërndarjes që përballen me sfidat e tregut konkurrues dhe nivelet në rritje të shkëmbimit të të dhënave në kohë reale.

Rrjeti shpërndarës elektrik është mjaft kompleks duke ditur që përfshin një numër të madh elementesh. OSSh pas realizimit të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit në nivelin e tensionit të mesëm, ka vazhduar me zbatimin e këtij procesi në nivel të tensionit të ulët.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 44 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Në rrjetin e shpërndarjes ka një numër të madh të stabilimenteve shpërndarëse 10(20)/0.4 [kV] të vendosura në pika të ndryshme në të cilat mund të instalohet sistemi SCADA. Pra numri i stabilimenteve të cilat janë të pajisura me mbrojtje rele dhe që plotësojnë kushtet për të instaluar në to sistemin SCADA është i lartë, mirëpo nga të gjitha stabilimentet e identifikuar në terren është bërë përzgjedhja e pikave se ku do të bëhet instalimi i sistemit SCADA.

Gjatë viteve 2023-2025 OSSH ka përfshirë numrin më të madh të stabilimenteve në sistemin aktual të kontrollit duke arritur që të realizoj me sukses instalimin e sistemit SCADA në stabilimentet kryesore të rrjetit elektrik. Me anë të këtij instalimi OSSH arrijnë që t'i monitoroj dhe kontrolloj pikat kyçe të rrjetit elektrik duke pasur qasje të plotë edhe në degëzimet e daljeve 10-20 [kV] në stabilimente.

Sistemi SCADA gjatë vitit 2026 planifikon që të zgjerohet edhe më tutje duke përfshirë edhe 14 stabilimente të tjera të cilat do të identifikohen varësisht parametrave bazë të selektimit të pikave se ku do të instalohet sistemi i tillë. Në secilin prej stabilimenteve në të cilat parashihet të instalohet sistemi, punimet në terren të kryera për zbatimin e sistemit SCADA dhe ndryshimet e bëra në pajisje të ndryshme gjatë zbatimit të këtij projekti do të përfshijnë:

- Instalimin e releve
- Instalimin e baterive dhe ridrejtuesve
- Instalimin e kablllove me fibra optike dhe kablllove të transmetimit të të dhënave
- Instalimin e kablllove të sinjalizimit
- Instalimin e sensorëve të lëvizjes dhe zjarrit
- Konfigurimin e releve
- Instalimin e RTU Panel-it
- Instalimin e infrastrukturës për komunikim

Nga projekti mostër i paraqitur më lartë mund të arrijmë në përfundimin se përzgjedhja e stabilimenteve në të cilat do të bëhet instalimi i sistemit SCADA është bërë në bazë të:

- Numrit të konsumatorëve
- Numrit të transformatorëve shpërndarës
- Profilit të ngarkesës
- Regjistrimeve të prishjeve
- Pikës kyçëse kritike

Përfitimet e instalimit të SCADA në stabilimente do të jenë të mëdha sepse një integrim i tillë do të ndihmojë në monitorimin dhe kontrollin e pikave më kritike të rrjetit të shpërndarjes.

Sistemi SCADA i realizuar në stabilimente, në të njëjtën mënyrë si në nënstacione do të regjistroj në kohë reale informacionet e vlerave analoge, pozicionet e elementeve të kthinave, defekteve që ndodhin në teren duke arritur që këto të dhëna që pranohen të përpunohen për t'i shërbyer proceseve të mëposhtme të shërbimeve si:

- Detajet e defekteve (avarive) dhe efektet e tyre në cilësinë e energjisë
- Raportimin për cilësinë e furnizimit

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 45 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

- Monitorimin e gjendjes së kthinave në stabilimente dhe kontrollimi në distancë i instalimeve dhe pajisjeve të rrjetit
- Optimizmin e aseteve të rrjetit sipas ngarkesës aktuale

Me anë të realizimit të sistemit SCADA në stabilimente apo nënstacione sekondare, OSSh synon që të:

- Monitoroj dhe kontrolloj pikat më kritike të rrjetit shpërndarës
- Zvogëloj kohëzgjatjen e ndërprerjeve të paplanifikuara/avarive
- Parandaloj dhe reagojë shpejt ndaj çdo prishje
- Rris efikasitetin dhe cilësinë e fuqisë punëtore

Rezultatet apo përfitimet e pritshme pas realizimit të sistemit SCADA në stabilimente janë:

- Ankesat e konsumatorëve do të zvogëlohen
- Puna e ekipeve të rrjetit do të zvogëlohet
- Zbulimi më i shpejtë i pikës së defektit/avarisë
- Kohëzgjatja e ndërprerjeve do të zvogëlohet
- Zvogëlimi i çdo manovrimi të rrezikshëm në perspektivën e H&S
- Analiza të detajuara të sistemit të shpërndarjes

**Përditësimi, Implementimi dhe Projektimi Inxhinierik i SCADA-s:** Sistemi SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition) përbën një nga komponentët më kritikë për funksionimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë. Ky sistem është aktiv për më shumë se 7 vite, duke operuar vazhdimisht dhe duke luajtur një rol kyç në garantimin e sigurisë operationale, efikasitetit të menaxhimit të rrjetit dhe kualitetit të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët. SCADA është komponent kyç për funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin e Kosovës. Çdo defekt në funksionimin e sistemit SCADA ndikon në aftësinë për të menaxhuar ngarkesat, për të identifikuar dhe reaguar ndaj avarive, dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor. Në kontekstin e zhvillimeve të fundit, si rritja e kërkesës për energji, dekarbonizimi i sektorit energjetik dhe integrimi i burimeve të ripërtëritshme, sistemi SCADA duhet të jetë plotësisht funksional, i mirëmbajtur dhe i përditësuar për të përmbushur këto sfida të reja.

Pajisjet ekzistuese harduerike dhe komponentët softuerikë të këtij sistemi kanë arritur ose tejkaluar ciklin e tyre të rekomanduar të jetës funksionale, ndaj mirëmbajtja e rregullt, përditësimet teknologjike dhe përkrahja teknike janë domosdoshmëri strategjike dhe operative.

Arsyet kyçe për përditësimin e domosdoshëm të sistemit SCADA janë:

#### **Tejkalimi i ciklit jetësor të pajisjeve harduerike:**

- Shumica e pajisjeve kanë kaluar ciklin standard të operimit (zakonisht 5–7 vite për komponentë kritikë industrialë).
- Rritet rreziku i dështimeve teknike, duke ndikuar drejtpërdrejt në vazhdimësinë dhe sigurinë e operationeve.
- Furnizimi me pjesë rezervë për pajisjet ekzistuese po bëhet gjithnjë e më i vështirë dhe me kosto më të lartë, për shkak të daljes nga prodhimi ose mbështetja nga prodhuesit (End of Support/Life).

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 46 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

### **Nevoja për përditësim të platformave softuerike:**

- Mungesa e përditësimeve rrit rrezikun për sulme kibernetike, të cilat për sistemet kritike si SCADA mund të kenë pasoja serioze për gjithë rrjetin.
- Softuerët e përditësuar ofrojnë funksionalitete të avancuara për automatizim, raportim, analizë të avancuar të të dhënave (analytics) dhe integrim më të lehtë me sisteme të tjera operative

### **Siguria kibernetike dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare:**

- Sipas standardeve ndërkombëtare si IEC 62443, NIST SP 800-82 dhe kërkesave të rrjeteve energjetike moderne, sistemet SCADA duhet të kenë arkitekturë të sigurt, kontrolle të aksesit dhe mekanizma për mbrojtje ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme. Prandaj është e nevojshme që sistemi të përditësohet kohë pas kohe në mënyrë që të jetë i mbrojtur.

### **Kostoja e mosmirëmbajtjes është shumë më e lartë se ajo e mirëmbajtjes:**

- Mospërditësimi dhe zhvillimi inxhinierik i sistemit SCADA sjell pasoja financiare shumëfish më të mëdha, përfshirë ndalje të papritura të sistemit, humbje në furnizim, ndërprerje të të dhënave.
- Ndërhyrjet emergjente janë më të shtrenjta, më të vështira për t'u koordinuar dhe mund të përfshijnë kosto të larta për zëvendësim të pajisjeve në kushte urgjente.

Duke analizuar në mënyrë të gjithanshme gjendjen aktuale të sistemit SCADA, rëndësinë e tij për rrjetin elektroenergjetik të Kosovës dhe sfidat që lidhen me kohëzgjatjen e funksionimit të tij, është e qartë se përditësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi përbëjnë një domosdoshmëri operacionale, teknike dhe strategjike.

Sistemi SCADA nuk është thjesht një komponent teknik – ai është sistemi kryesor digjital i operimit të rrjetit, që siguron monitorimin në kohë reale, ndërhyrjen e menjëhershme në rast të avarive, optimizimin e ngarkesave dhe menaxhimin efikas të rrjetit të shpërndarjes. Çdo degradim në performancën e këtij sistemi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe sigurinë teknike të rrjetit.

Duke qenë se disa nga pajisjet dhe platformat ekzistuese kanë tejkaluar jetën e tyre funksionale të rekomanduar, rritet ndjeshëm rreziku për dështime sistematike, ndërprerje të paautorizuara të operimit, humbje të të dhënave kritike, si dhe ekspozim ndaj rreziqeve kibernetike. Masat parandaluese, përditësimi i softuerëve dhe zëvendësimi i pajisjeve përbëjnë një investim të nevojshëm për të shmangur pasoja shumë më të mëdha në të ardhmen si në aspektin financiar, ashtu edhe në atë të reputacionit institucional dhe operimit të sigurt të rrjetit. Në një kohë kur rrjeti i shpërndarjes po përballet me sfida të reja përfshirë integrimin e burimeve të ripërtëritshme, rritjen e konsumit, nevojën për automatizim më të lartë dhe kërkesat për efikasitet energjetik sistemi SCADA duhet të jetë i përgatitur për të përmbushur këto kërkesa të reja. Kjo është e mundur vetëm nëse ky sistem trajtohet në mënyrë profesionale, përditësohet rregullisht dhe evoluon në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe standardet ndërkombëtare.

**Daljet e mençura:** Gjatë vitit 2026 OSSH do të tentoj që të implementoj sistemin e rrjetit të mencur në një dalje të tërë. Qëllimi i këtij projekti është që një dalje ekzistuese e rrjetit të shpërndarjes (në tension të mesëm dhe të ulët) të transformohet në një dalje tërësisht të automatizuar, të monitoruar dhe të

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 47 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

menaxhueshme në mënyrë digjitale në kohë reale, përmes instalimit të pajisjeve inteligjente në të gjitha pikat kyçe duke filluar nga nënstacioni i daljes së TM, deri te kabllot dhe kabinetet e TM/TT në teren dhe pikat fundore të furnizimit.

Në kuadër të përpjekjeve për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe rritjen e nivelit të digjitalizimit dhe automatizimit operacional, ky projekt synon transformimin e një daljeje ekzistuese të tensionit të mesëm (TM) në një dalje tërësisht të mençur dhe inteligjente (Full Smart Feeder), duke përfshirë në mënyrë të integruar edhe rrjetin përkatës të tensionit të ulët (TU).

Ky pilot projekt do të shërbejë si model referues për digjitalizimin e daljeve të tjera të rrjetit, në përputhje me direktivat strategjike për ndërtimin e një rrjeti të mençur, efikas dhe të qëndrueshëm, në përputhje me standardet dhe praktikën më të avancuar ndërkombëtare në sektorin energjetik.

Qëllimi i projektit është të mundësojë:

- Monitorim dhe komandim në kohë reale të të gjitha elementeve të rrjetit në atë dalje,
- Identifikim automatik i defekteve, segmentim të zonave të prishjes dhe rikthim të furnizimit në pjesët jo të afektuara
- Matje dhe analizë të vazhdueshme të parametrave teknikë, në mënyrë që të optimizohet funksionimi i rrjetit dhe të reduktohen humbjet teknike dhe jo-teknike
- Integrim i plotë i sistemit të komunikimit dhe sigurisë kibernetike, duke garantuar transmetim të besueshëm të të dhënave drejt sistemeve qendrore si SCADA, DMS dhe AMI.

Projekti synon të krijojë një dalje të automatizuar dhe të monitoruar në të gjitha segmentet e saj:

- Në nivelin e tensionit të mesëm, përmes instalimit të sistemit SCADA, seksionalizatorëve, FID-ve, sensorëve të rrjedhës dhe tensionit, motorizimit të disa pajisjeve shtesë.
- Në nivelin e tensionit të ulët, përmes instalimit të matësve të mençur (smart meters), pajisjeve monitoruese për TU, njësive të komunikimit me platformën AMI etj.
- Gjithashtu, parashikohet vendosja e pajisjeve të mençura në pikat kyçe të rrjetit, për të ndjekur performancën e rrjetit në kohë reale, për të marrë vendime automatike në rast të defekteve, dhe për të menaxhuar më mirë ngarkesat, tensionet dhe balancimin e fazave.

Metodologjia e implementimit është planifikuar në 4 faza kryesore, ku aktivitetet kryesore në pika më të zgjeruara janë dhënë në tabelën më poshtë:

*Tabela 25. Fazat e Realizimit të Daljeve të Mencura.*

| Faza   | Përshkrimi                 | Aktivitetet Kryesore                                                     |
|--------|----------------------------|--------------------------------------------------------------------------|
| Faza 1 | Planifikimi dhe projektimi | Analizë e detajuar e daljes së zgjedhur (rrjet, kapacitete, konsumatorë) |
|        |                            | Hartimi i skemave elektrike dhe të komunikimit                           |
|        |                            | Përzgjedhja e teknologjisë dhe furnitorëve në përputhje me standardet    |

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 48 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

|        |                                                          |                                                                        |
|--------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|
| Faza 2 | Instalimi i pajisjeve në TM dhe integrimi në SCADA       | Instalimi i pajisjeve në nënstacione dhe pika të ndërprerjes në terren |
|        |                                                          | Testim i komunikimit dhe konfigurim i mbrojtjeve                       |
|        |                                                          | Integrim me sistemin ekzistues SCADA                                   |
| Faza 3 | Instalimi i pajisjeve në TU dhe aktivizimi i monitorimit | Instalimi i matësve të mençur dhe paneleve inteligjente                |
|        |                                                          | Aktivizimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave në AMI                |
|        |                                                          | Trajnimi i stafit për monitorim të rrjetit TU                          |
| Faza 4 | Testim, kalibrim dhe vënia në funksion                   | Testim i plotë funksional                                              |
|        |                                                          | Simulime për avari, automatizim dhe rikthim të tensionit               |
|        |                                                          | Vënia e plotë në funksion                                              |

Përmes këtij projekti, priten këto rezultate kryesore:

- ❖ Reduktim i kohës së ndërprerjeve dhe përmirësim i besueshmërisë së rrjetit.
- ❖ Mundësi për vendimmarrje në kohë reale, me bazë në të dhëna të sakta dhe të vazhdueshme.
- ❖ Ndërveprim i plotë me sistemet digjitale: SCADA, AMI, GIS, DMS
- ❖ Krijimi i një baze për zgjerimin e konceptit të rrjetit të mençur në shkallë më të gjerë në të ardhmen.
- ❖ Mundësi të aplikimit të sistemit FLISR (Fault Location, Isolation and Service Restoration - Lokacioni i Defektit, Izolimit dhe Rikthimi i Furnizimit) gjatë procesit të operimit

**Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS):** Pilot projekti, i cili u përfundua me sukses pas mbledhjes së të dhënave nga punëtorët e KEDS-it u paraqit për shqyrtim dhe konfirmim nga Zyra e Regulatorit të Energjisë (ZRRE). Pas marrjes së konfirmimit dhe miratimit nga ky organ, DSO ka vazhduar me përgatitjen e nevojshme për të nisur fazat e mëtejshme të projektit.

Gjatë kësaj periudhe, DSO ka qenë aktivisht i angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Kjo përfshin të gjitha specifikimet teknike, përshkrimin e projektit dhe çështje të tjera të lidhura me realizimin e projektit. Për më tepër, kompania ka përfunduar punën për të përcaktuar kërkesat dhe objektivat e projektit, të cilat janë thelbësore për implementimin e sistemit të mbledhjes së të dhënave në terren. Derimë tani, janë alokuar burimet e nevojshme njerëzore për projektin dhe po formohen grupet e brendshme të projektit për integrimin e sistemit sapo të zgjidhet kontraktori. Nga ana tjetër, një investim tjetër ka qenë blerja e pajisjeve thelbësore, përfshirë pajisje për lokalizimin dhe detektimin e kabllave dhe një dron

Disa nga aktivitetet kryesore të cilat do të zhvillohen gjatë vitit 2026 janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 26. Aktivitetet kryesore në projektin GIS.*

| Nr. | Aktiviteti                           | Përshkrimi i përgjithshëm                                                                                   |
|-----|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | Verifikimi i infrastrukturës teknike | Sigurimi që infrastruktura përmbush kërkesat teknike                                                        |
| 2   | Mbledhja e të dhënave ekzistuese     | Grumbullimi i të dhënave të TM/TU nga burime të ndryshme digjitale (Google Earth, AutoCAD, XLS, PDF, JPEG). |
| 3   | Mbledhja e të dhënave nga terreni    | Përdorimi i tabletave me GPS për mbledhje të aseteve dhe elementeve në terren.                              |

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 49 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

|    |                                       |                                                                                                                                           |
|----|---------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 4  | Regjistrimi i lidhjeve elektrike      | Krijimi i lidhjeve teknike ndërmjet shtyllave, paneleve dhe pikave të konsumatorëve.                                                      |
| 5  | Përditësimi i skemave SLD             | Rishikimi dhe korrigjimi i skemave teknike bazuar në gjetjet nga terreni.                                                                 |
| 6  | Detektimi i rrjeteve nëntokësore      | Përdorimi i pajisjeve për detektim dhe regjistrim të traseve nëntokësore dhe puseta.                                                      |
| 7  | Verifikimi i KKSH dhe njehësorëve     | Mbledhja dhe krahasimi i numrave të njehësorëve dhe KKSH me të dhënat e KEDS.                                                             |
| 8  | Vendosja e pllakëzave identifikuese   | Montimi i pllakëzave me numra identifikues në të gjitha asetet dhe regjistrimi i tyre në GIS sipas standardeve.                           |
| 9  | Dokumentimi fotografik                | Fotografimi i aseteve kryesore dhe organizimi me emërtime të standardizuara.                                                              |
| 10 | Verifikimi i gjendjes së ndërprerësve | Regjistrimi i statusit të ndërprerësve në rrjet dhe përputhja me SLD për të menaxhuar rrjedhën operative dhe normale të rrymës elektrike. |
| 11 | Pozicionimi GPS i saktë               | Vendosja e saktë gjeohapësinore e aseteve sipas të dhënave të GPS.                                                                        |
| 12 | Krijimi i lidhjeve gjeografike        | Krijimi i rrjetit të plotë të lidhjeve elektrike në GIS për TM dhe TU.                                                                    |
| 13 | Konsolidimi i të dhënave në zyrë      | Përpunimi dhe integrimi i të dhënave të terrenit në modelin GIS të KEDS.                                                                  |
| 14 | Raportimi i anomalive                 | Njoftimi i KEDS për mundësinë e mospërputhjeve, mungesa të dhënash apo probleme cilësie.                                                  |
| 15 | QA/QC dhe validiteti                  | Kryerja e kontroleve të cilësisë, topologjisë dhe analizave të rrjetit.                                                                   |
| 16 | Organizimi i ekipeve                  | Organizimi i ekipeve në zonat e caktuara                                                                                                  |
| 17 | Integriteti i daljes (feeder)         | Koordinimi i punës sipas strukturës së rrjedhës së energjisë për efikasitet.                                                              |

Disa nga përparësitë kryesore të realizimit të sistemit GIS në Kosovë janë:

- ✓ Vizualizim i saktë i rrjetit në kohë reale: GIS mundëson një hartë digjitale ku të gjitha elementet e rrjetit (kabllot, trafot, shtyllat, etj.) janë të pozicionuara me koordinata gjeografike të sakta.
- ✓ Menaxhim më efikas i aseteve: Të gjitha asetet e rrjetit (trafot, linjat, lidhjet, konsumatorët) mund të ruhen, përditësohen dhe menaxhohen në mënyrë të centralizuar dhe të integruar.
- ✓ Reagim më i shpejtë ndaj defekteve dhe avarive: Në rast defekti, GIS ndihmon në lokalizimin e saktë të problemit, duke e reduktuar kohën e reagimit dhe riparimit.
- ✓ Planifikim dhe analizë më e mirë e rrjetit: GIS ofron mundësi për të analizuar kapacitetet ekzistuese, ngarkesat dhe nevojat për zgjerim apo modernizim të rrjetit.
- ✓ Integrim me sisteme të tjera (SCADA, AMI, DMS): GIS mund të lidhet me sisteme të avancuara të automatizimit për të krijuar një rrjet të mençur (smart grid) dhe për të ndihmuar në izolimin automatik të defekteve.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 50 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

- ✓ Përmirësim i shërbimit ndaj konsumatorit: Lejon lokalizimin e saktë të konsumatorëve dhe rrugën më të shkurtër për ekipet e mirëmbajtjes, si dhe ndihmon në menaxhimin e kërkesave për lidhje të reja.
- ✓ Reduktim i humbjeve teknike dhe jo-teknike: Përmes analizës së rrjetit dhe konsumit, GIS ndihmon në identifikimin e humbjeve dhe ndërhyrjeve ilegale.
- ✓ Vendimmarrje më e informuar dhe strategjike: Menaxhmenti mund të marrë vendime bazuar në të dhëna vizuale dhe analitike për investime, mirëmbajtje dhe zgjerim të rrjetit.
- ✓ Përgatitje dhe menaxhim më i mirë për situata emergjente: GIS ndihmon në përgatitjen e skenarëve për ndërprerje të mëdha dhe koordinimin e veprimeve në rast fatkeqësish natyrore apo emergjencash.
- ✓ Dokumentim i përhershëm dhe i strukturuar i rrjetit: Të gjitha të dhënat historike dhe teknike për rrjetin ruhen në një bazë të dhënash të sigurt, që ndihmon në koordinim dhe planifikim afatgjatë.

**Sistemi i Menaxhimit të Ndërprerjeve (OMS):** Për të menaxhuar më mirë situatat e ndryshme (defektet, shkyçjet, operimet) që ndodhin në rrjetin e shpërndarjes, KEDS përdor aplikacionin Kosova Net i cili i ndihmon operatorët të regjistrojnë të gjitha shkyçjet/kycjet e bëra në sistem. Një nga mangësitë e sistemit KosovaNet është se të gjitha shkyçjet dhe defektet manuale duhet të regjistrohen nga operatori manualisht në program. Në rastet kur ka shumë defekte, operatori do ta ketë të vështirë t'i regjistrojë të gjitha me kohë në mënyrë që sistemi të jetë në gjendje të tregojë një pasqyrë të qartë të ndërprerjeve në kohë reale për Kosovën. Për të përkrahur funksione të tjera shtesë të cilat duhet pasur për të menaxhuar ndërprerjet, për të regjistruar të gjitha defektet dhe punët e planifikuara në mënyrë automatike si duhet dhe për të përshpejtuar të gjitha proceset është e domosdoshme që të realizohet sistemi **OMS (Outage Management System)**, që ka funksione superiore për shkak të ndërlidhjes që do të ketë me sistemin SCADA/DMS dhe sistemet e tjera të mençura. Mbi të gjitha OMS do të përdoret për të ndihmuar lokalizimin, analizën e detajuar dhe rregullimin e ndërprerjeve të energjisë në rrjet.

OSSH planifikon që në Sistemin e Menaxhimit të Ndërprerjeve (OMS) të integrojë funksione të ndryshme të avancuara si:

- Menaxhimi dhe zgjidhja e ndërprerjeve të paplanifikuara
- Menaxhimi, zgjidhja dhe kryerja e punëve të planifikuara – Punimet e planifikuara në rrjet krijohen drejtpërdrejt në qendrën e kontrollit dhe janë rezultat i një kërkesë ndërprerjeje të pranuar. Autoritetet përgjegjëse duhet të përcaktojnë procedurat e punës, punën që duhet të realizohet, ekipet të cilat do të punojnë dhe oraret e operimit.
- Menaxhimi i ekipeve në teren – duke përcaktuar për secilën prej ekipeve detyrat “tasks” që ata duhet përfunduar.
- Parashikime të ndërprerjeve që mund të ndodhin.
- Ndërlidhje automatike me sistemin AMR dhe me Qendrën e Thirrjeve prej të cilave në mënyrë automatike do të merren të dhëna të ndryshme.
- Llogaritje automatike të kohës së parashikuar për restaurim të defekteve.
- Storm Management – Sistemi i menaxhimit të ndërprerjeve ofron mundësinë për të trajtuar numrin e madh të telefonatave me probleme nga konsumatorët gjatë kushteve të jashtëzakonshme, dhe gjithashtu ofron mundësinë për të trajtuar një numër të madh sinjalesh nga njehsorët dhe nga sistemi SCADA.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 51 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

- Vlerësimi i dëmit për çdo avari (defekt) - Kur një ekipë gjatë kohës së defekteve (avarive) gjen dëme që kanë një ndikim të mundshëm në detyrën ose ndërprerjen ku ata janë duke punuar, ekipa informon operatorin i cili krijon një regjistër dëmtimi për secilin defekt.
- Dispeçimi i ekipeve të duhura – Ekipet e OSSH të cilat realizojnë punime të planifikuara dhe që intervenojnë në teren për të restauruar të gjitha defektet përbëhen nga staf me grupe aftësish specifike për punët përkatëse, posedojnë pajisje dhe makineri të ndryshme. Operatori përmes OMS mund të caktojë ekipet për ndërprerjet duke përdorur ekranin e Menaxhimit të Ndërprerjeve. Përzgjedhja e ekipeve të përshtatshme mbështetet duke treguar aftësitë, pajisjet dhe makineritë e ekipeve, si dhe kohën kur ekipet janë të disponueshme.
- Raportimi në kohë reale dhe me saktësi për të gjitha defektet (avaritë në rrjet)
- Analiza dhe raportime të formateve të ndryshme
- Llogaritja automatike e indekseve më të rëndësishme si SAIDI, SAIFI, CAIDI, CAIFI etj.

**Monitorimi i rrjetit TU:** Monitorimi në nivel të tensionit të ulët (TU) do t'i siguroj të dhëna që mund të identifikojnë çështjet dhe të ndihmojnë me projektimin dhe kontrollin e rrjeteve të TU. Përderisa OSSH përmes sistemeve të ndryshme të avancuara ka pamje të qartë të asaj që ndodh në rrjetin e tensionit të mesëm, informatat nga rrjeti i tensionit të ulët mungojnë. Monitorimi i ngarkesave dhe daljeve nga panelet e tensionit të ulët të OSSH 10/0.4 [kV] apo 20/0.4 [kV] do të thotë se ne mund të shohim çdo zonë që është e mbingarkuar. Monitorimi i rrjetit të ulët do t'i mundësoj OSSH-së të jetë në gjendje të vlerësoj me saktësi ndikimin e ngarkesave të kyçura në rrjetin e tensionit të ulët, duke përfshirë lidhjet e reja, që nënkupton se mund të eksplorohet se si të përdoret më së miri rrjeti i tensionit të ulët për të mbështetur kërkesën në rritje në qytete.

Përdorimi efikas i të dhënave të monitorimit mund të zvogëlojë kostot, të optimizojë investimet dhe të përmirësojë shërbimin dhe sigurinë ndaj klientit sa i përket furnizimit me energji elektrike. Monitorimi do të ndihmoj në optimizimin e përdorimit të rrjetit dhe reduktimit të humbjeve të linjës. Përmes monitorimit mund të rritet cilësia e energjisë. Cilësia e përmirësuar e energjisë zvogëlon humbjet dhe në këtë mënyrë rrit kapacitetin efektiv në rrjet.

OSSH duke pasur një sistem të avancuar të monitorimi të tensionit të ulët që identifikon, regjistron dhe ofron të gjithë informacionin në rrjetin e shpërndarjes, duke përfshirë detajet për secilën linjë furnizimi dhe fazë, do të arrij të kontrolloj dhe menaxhoj një rrjet shpërndarjeje të tensionit të ulët.

Gjatë fundit të periudhës 2026-2030 OSSH planifikon që të filloj një projekt ku do të përzgjidhen **transformatorë** në distrikte të ndryshme. Panelet e tensionit të ulët të këtyre transformatorëve, daljet e ndryshme të tyre parashihen të monitorohen nga distanca dhe të integrohen në sistemin aktual të SCADA-s. Nga monitorimi i paneleve të tensionit të ulët do të mund të lexohen të dhëna nga më të ndryshmet: si rrymat për fazë, tensionet, fuqia aktive, fuqia reaktive, frekuenca, temperatura, harmonikët, luhatjet e tensionit.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 52 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

## 5. NJEHSORËT

Që nga viti 2007 filloi vendosja e njehsorëve elektronik dhe deri tani pothuajse 90.44% të konsumatorëve iu janë zëvendësuar njehsori, megjithatë një tjetër 9.6% e konsumatorëve janë ende të furnizuar me njehsorë elektromekanik, ashtu siç tregohet në tabelën në vijim:

*Tabela 27. Numri i njehsorëve aktiv.*

| Grupet tarifore | Aktiv        |                |                |               |
|-----------------|--------------|----------------|----------------|---------------|
|                 | Mençur C>1   | Mençur C=1     | Elektronik     | Mekanik       |
| Treg i hapur    | 1,241        | 2,812          | 2,953          | 129           |
| 1/2             | 19           | -              | -              | 2             |
| 1/3             | 294          | -              | -              | -             |
| 4/01            | -            | 1              | 37             | 1,915         |
| 4/02            | 19           | 104,304        | 466,937        | 61,336        |
| 6/6             | 2,582        | -              | -              | 2             |
| 7/01            | -            | -              | 24             | 837           |
| 7/02            | 668          | 13,342         | 70,341         | 6,510         |
| 8/01            | 66           | 785            | 3,116          | 14            |
| <b>Total</b>    | <b>4,889</b> | <b>121,244</b> | <b>543,408</b> | <b>70,745</b> |

Nga të gjithë konsumatorët aktivë që i përkasin grupeve tarifore 1/2, 1/3, 6/6 dhe pjesërisht 7/02, matja e energjisë elektrike bëhet me njehsor të mençur elektronik, ndërsa për konsumatorët shtëpiak që i përkasin grupeve tarifore 4/02, 4/01, grupet tarifore 7/1, 8/01 dhe disa nga konsumatorët që janë në grupin tarifor 7/02, matja e energjisë elektrike bëhet me njehsor elektromekanik, njehsor elektronik dhe ata të mençur.

**Njehsorët mekanik** zakonisht kanë attribute të mira, por në Kosovë këta njehsorë janë shumë të vjetër (të prodhuara para vitit 2000) dhe si të tillë është shumë e kushtueshme dhe e vështirë mirëmbajtja e tyre, veçanërisht sepse disa nga pjesët që duhet të zëvendësohen mungojnë në treg, meqenëse ato nuk prodhohen më si të tilla.

**Njehsorë elektronik** janë ato që shfaqin energjinë e konsumuar në LCD. Përveç matjes së energjisë së konsumuar, këta njehsorë mund të regjistrojnë edhe parametra të tjerë të ngarkesës dhe furnizimit, të tilla si vlerat momentale dhe Pmax, profilin e ngarkesës, tensionet, rrymat etj. Ata gjithashtu mundësojnë regjistrimet për faturim, duke regjistruar shumën e energjisë së konsumuar sipas tarifave ditore dhe sezonale.

**Njehsorët e mençur** gjithashtu shfaqin energjinë e konsumatorit në LCD, por ato gjithashtu mund të transmetojnë lexime në largësi. Përveç matjes së energjisë së konsumuar, këta matës mund të regjistrojnë edhe parametra të tjerë të ngarkesës dhe furnizimit, siç janë vlerat momentale dhe Pmax, profilin e ngarkesës, tensionet, rrymat, faktori i fuqisë, energjia reaktive etj. Më tej ato mundësojnë regjistrimin e faturimit duke regjistruar sasinë e energjisë së konsumuar sipas tarifave ditore dhe sezonale. Njehsorët e

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 53 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

mençur mundësojnë komunikimin në mënyrë të dyanshme ndërmjet njehsorit dhe sistemit qendror në mënyra të ndryshme të komunikimit.

Në pajtim me rregulloren e MTI-së për validimin e vulës "Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 02/2015 për Periudhën e Verifikimit të Matjes Ligjore", i plotësuar/ndryshuar me Ligjit nr.06/L-037 për Metrologji, gjegjësisht rregullores Rregullore (MINT) Nr. 01-2022, dt. 09.08.2022, tabela ne vazhdim:

| Nr.      | Mjeti matës                                                                            | Kategoria dhe fusha e matjeve                                                                                                                                  | Vlerësimi i konformitetit - Vlerësimi i tipit |                  | Kontrolli ligjor metrologjik       |                   | Referenca e procedurave             |
|----------|----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|------------------|------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|
|          |                                                                                        |                                                                                                                                                                | D-EU                                          | Aprovimi i tipit | Verifikimi fillestar               | Verifikimi pasues |                                     |
| 04.01.01 | Njehsorët elektrik për matje të energjisë në amvisëri, tregti dhe të industri të lehtë | Njehsorët elektrik induktiv një fazor dhe shumë fazorë të energjisë elektrike të rrymës alternative të kyçur drejtpërdrejt                                     | MID                                           |                  | Jo                                 | 12 vite           | OIML R 46:2012 dhe<br>ISO ICS 17220 |
| 04.01.02 |                                                                                        | Njehsorët elektrik induktiv njëfazor dhe shumë fazorë të energjisë elektrike të rrymës alternative të kyçur përmes transformatorëve matës                      |                                               | Po               | Po ( vetëm për energji reaktive)   | 8 vite            |                                     |
| 04.01.03 |                                                                                        | Njehsorët elektrik elektronik një fazor dhe shumë fazorë të energjisë elektrike aktive të rymës alternative të kyçur drejtpërdrejt                             |                                               | MID              | Jo                                 | 12 vite           |                                     |
| 04.01.04 |                                                                                        | Njehsorët elektrik elektronik njëfazor dhe shumë fazorë të energjisë elektrike aktive dhe reaktive të rymës alternative të kyçur përmes transformatorëve matës | MID                                           |                  | Po<br>(vetëm për energji reaktive) | 8 vite            |                                     |
| 04.01.05 |                                                                                        | Njehsorët elektrik elektronik njëfazor dhe shumë fazorë të energjisë elektrike aktive dhe reaktive të rymës alternative të kyçur përmes transformatorëve matës |                                               | Po               | Po                                 | 8 vite            |                                     |

Figura 7. Njehsorët e energjisë elektrike.

Ne vazhdim është gjendja e njehsorëve sipas rregullores se lartpërmendur:

Tabela 28. Validimi / Miratimi i pllombës së njehsorit.

| Pllombat e skaduar AMK _MINT | Aktiv      |            |            |         |
|------------------------------|------------|------------|------------|---------|
|                              | Mençur C>1 | Mençur C=1 | Elektronik | Mekanik |
| Deri 2020                    | 142        | 224        | 67,333     | 63,159  |
| 2021                         | 37         | -          | 1,830      | 4,241   |
| 2022                         | 73         | -          | 6,262      | 1,387   |
| 2023                         | 98         | 72         | 75,809     | 951     |
| 2024                         | 160        | 7,979      | 69,793     | 620     |

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 54 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

|              |              |               |                |               |
|--------------|--------------|---------------|----------------|---------------|
| 2025         | 269          | 14,967        | 45,909         | 83            |
| 2026         | 89           | 13,070        | 79,851         | 304           |
| 2027         | 1,098        | 21,745        | 45,756         | -             |
| 2028         | 100          | 17,055        | 72             | -             |
| 2029         | -            | 9,642         | 32,809         | -             |
| 2030         | 952          | 2,897         | 3,908          | -             |
| <b>Total</b> | <b>3,018</b> | <b>87,651</b> | <b>429,332</b> | <b>70,745</b> |

Që nga viti 2017 konsumatorët shtëpiakë kanë pasur të drejtë të zgjedhin furnizuesin e energjisë elektrike, që do të thotë se ata kanë mundësinë të zgjedhin furnizuesin e tyre.

Me hapjen e tregut njehsorët e mençur janë bërë një domosdoshmëri, sepse ata regjistrojnë profilin e ngarkesës, vlerat Pmax, të cilat do të sigurojnë zotërimin e informacionit në kohë reale dhe nuk do të shkaktojnë ndonjë problem sa herë që një konsumator ndryshon furnizuesin e tij.

Bazuar në dobi të konsumatorit duke përdorur njehsorë elektronikë dhe njehsorë të mençur, OSSH ka përgatitur një plan për zëvendësimet e njehsorëve, siç paraqitet më poshtë:

*Tabela 29. Plani vjetor i projektit për investim te njehsorëve – sasia.*

| Viti                             | 2026           | 2027          | 2028           | 2029           | 2030           |
|----------------------------------|----------------|---------------|----------------|----------------|----------------|
| Njehsor të mençur                | 9,000          | 14,000        | 49,500         | 50,000         | 50,000         |
| Njehsor indirekt                 | 50             | 50            | 100            | 100            | 100            |
| Njehsor gjysmë indirekt          | 500            | 500           | 1,250          | 1,250          | 1,250          |
| Njehsor elektronik i thjeshtë    | 148,729        | 13,734        | 72,500         | 82,500         | 123,000        |
| Upgrade i pajisjeve testuese lab | 1              | 0             | 1              | 0              | 1              |
| <b>Total</b>                     | <b>158,280</b> | <b>28,284</b> | <b>123,350</b> | <b>133,850</b> | <b>174,350</b> |

### **Sistemi i automatizuar i monitorimit (2027-2028)**

Rritja e vazhdueshme e numrit të konsumatorëve, mungesa e njehsorëve të mençur në sistemin aktual dhe kostot e larta të investimeve për këta njehsorë po e bëjnë gjithnjë e më sfiduese punën tonë operative.

Në KEDS, planifikojmë të investojmë në automatizim dhe zgjidhje inteligjente për të menaxhuar në mënyrë qendrore këto operacione rutinë, për të parandaluar përshkallëzimin e tyre në të ardhmen dhe për të arritur efikasitet të fuqisë punëtore.

Me këtë projekt, KEDS synon një sistem të automatizuar që mundëson leximin dhe monitorimin njehsorëve pa lexim në distancë të njehsorëve të energjisë elektrike përmes telefonave celularë. Përveç kësaj, sistemi do të projektohet me disa module për të përmirësuar produktivitetin, efikasitetin dhe për të reduktuar humbjet teknike dhe komerciale në nivelin e operatorit të shpërndarjes (DSO).

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 55 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Sistemi bazë do të projektohet për leximin e njehsorëve, por do të përmbajë edhe disa nën-sisteme të pavarura që do të mundësojnë mbulimin dhe automatizimin e një game të gjerë aktiviteteve:

- Lexim i automatizuar i njehsorëve përmes njohjes vizuale
- Lexim i automatizuar i njehsorëve përmes sondave optike Bluetooth IR
- Mbrojtje dhe kontroll i automatizuar i njehsorëve me vula elektronike RFID për të parandaluar ndërhyrjet e paautorizuara në pikën e matjes
- Zbulim i automatizuar i manipulimeve të njehsorëve duke përdorur magnet
- Rugëtimi dhe gjurmimi i lexuesve dhe teknikëve në terren për të përmirësuar efikasitetin dhe produktivitetin në procesin e leximit, kontrollit dhe mirëmbajtjes së njehsorëve
- Sistem nga inteligjenca artificiale për zbulimin e humbjeve në rrjetin e tensionit të ulët dhe krijimin e planeve të veprimit për eliminimin e humbjeve teknike dhe komerciale.

### **Përfitimet Kryesore të Sistemit**

- Reduktim i vlerësuar i humbjeve totale në DSO deri në 1.2 [%] të totalit të zvogëlimit në përqindje
- Kostot operative për leximin e njehsorëve, inspektimet dhe aktivitetet e teknikëve të fushës mund të reduktohen deri në 10 [%]
- Kërkohen më pak lexues, kontrollera dhe teknike në terren, ndërsa monitorimi përmes GPS redukton më tej kostot e mirëmbajtjes për DSO
- Leximi pa kontakt i njehsorëve duke përdorur njohjen e objekteve do të eliminojë çdo interpretim subjektiv të të dhënave të konsumit
- Zgjidhja me sondë optike Bluetooth IR mundëson leximin e njëkohshëm deri në 5 njehsorë, duke përshpejtuar ndjeshëm procesin
- Kontroll automatik i gjendjes teknike të pajisjeve njehsorëve
- Mbrojtje 100 [%] e njehsorëve të energjisë elektrike me vula RFID të paprekshme
- Analiza, lokalizimi dhe vlerësimi i humbjeve në rrjetin e TU
- Prezantimi i menaxhimit të duhur të bazës së të dhënave
- Monitorim përmes GPS i stafit të terrenit
- Gjenerimi i raporteve të detajuara

OSSH ka në plan të ndryshojë edhe njehsorët tashmë të vendosur, pasi vlefshmëria e vulës së njehsorit normalisht kushton 60-80 [%] të çmimit të njehsorit të ri, duke përfshirë vetëm kostot e verifikimit dhe të transportit, dhe me operime të ndryshimit / zëvendësimit të njehsorit shpenzimet do të jenë deri në 90 [%] të kostos së njehsorit të ri.

Plani i OSSh për ndryshimet / zëvendësimet e njehsorëve është që të përqendrohet kryesisht në zonat të cilat janë më të vështira për qasje, si:

- Zonat rurale, ku është vështirë të ketë qasje në konsumator,
- Zonat rurale / pyjore, ku janë të vendosur kryesisht konsumatorë të vegjël,
- Zonat, ku janë konsumatorët problematikë,
- Zonat, ku konsumimi është i lartë dhe
- Zonat, sipas kërkesave që do të shfaqen.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 56 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Është e rëndësishme të theksohet se përfitimi i investimeve nga njehsorët do të sigurojë performancën e pandërprerë, vazhdimësinë e operacioneve, të dhënat e duhura për furnizuesit dhe efikasitetin në operacionet në aspektin e leximit dhe shkyçjes potenciale, duke përmbyshur kështu kërkesat e liberalizimit të tregut, si detyrime të tjera ligjore. Përfitimet e njehsorëve të mençur janë shumë të larta, dhe ato mund të përmbliken por të mos kufizohen me:

- Matjet e sakta (njehsorët elektronikë janë të klasës së lartë të saktësisë Cl.0.2, CLC dhe CL.B që varen nga konsumatori, kështu që konsumatori nuk mund të dëmtohet në lidhje me saktësinë e matjes në krahasim me njehsorët elektromekanike që shumë lehtë mund të devijojnë nga klasa e saktësisë për shkak të ndjeshmërisë të ndërtimit të tyre)
- Konsumatorët mund të informohen jo vetëm për sasinë e energjisë që konsumojnë, por edhe për kohën e konsumimit të tyre (njehsorët elektronik regjistrojnë rrjedhën e energjisë çdo 15 minuta, kështu që konsumatori do të dijë me saktësi kur ai ka konsum maksimal).
- DSM (Menaxhimi i Vendndodhjes së Kërkesave) - Zvogëlimi i konsumit përmes përdorimit racional të tarifave (njehsorët elektronik kanë sistem tarifash (mund të përfshijnë dy deri në katër tarifa) që funksionojnë në kohë reale duke u mundësuar konsumatorit të bëjë kontrollin racional të konsumit, duke përdorur tarifën e ultë (gjatë natës) dhe njëkohësisht redukton kulmin e përdorimit të energjisë elektrike.
- Njehsorët e mençur janë gjithmonë të sinkronizuar me kohë reale.
- Mbrojtja nga mbingarkesa (njehsorët elektronikë kanë mundësinë e kufizimit të fuqisë, që mbron konsumatorin nga mbingarkesa duke u shkëputur për momentin nga rrjeti ndërkohë që ul sasinë e konsumit).
- Faturimi është mujor dhe konsumatori nuk kërkohet të jetë i pranishëm me rastin e leximit (njehsori lexohet nga distanca dhe konsumatori duke pasur qasje në leximet e njehsorëve kontrollon faturën e tij, ndryshe nga rastet me njehsorët mekanik, të cilat gjenden brenda objektit rezidencial dhe në rast se konsumatori nuk gjendet aty nuk mund të bëhet leximi i njehsorit, rrjedhimisht konsumatori do të faturohet me mesataren e muajve të mëparshëm ose nuk do të faturohet dhe më pas në rast të faturimit të ri, konsumatori do të ngarkohet me faturimin e muajve të mëparshëm. Gjithashtu në njehsor elektronik, janë ruajtur edhe leximet e faturimit të muajve të mëparshëm).
- Në rastet e ankesave për shkak të gabimeve në lexime, defekte të ndryshme që mund të ndodhin në sistem, me njehsor elektronikë përcaktohen me saktësi kohën kur ka ndodhur gabimi.
- Shmangia e defekteve të natyrave të ndryshme në njehsorë (djegia e njehsorit, defekt në disa faza etj.), objekti për të jetuar tek konsumatori është i sigurt sepse njehsori është instaluar në shtylle dhe në rast të ndonjë prishje është dëmtuar vetëm njehsori.
- Kontrolli i cilësisë së tensionit të rrjetit (vlerat e regjistruarit të njehsorëve çdo 15 minuta të tensionit dhe në rastet e ndonjë furnizimi jo adekuat konsumatori mund të kontrollojë gjendjen e rrjetit. Gjithashtu njehsori regjistron vlerat aktuale çdo 15 minuta).
- Kontrolli i cilësisë së energjisë të ofruar nga furnizuesi: SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjes së Sistemit) – paraqet mesatarja aktuale e mungesës së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët dhe SAIFI (Indeksi i Frekuencave të Ndërprerjes Mesatare të Sistemit) - paraqet numrin mesatar të ndërprerjeve të energjisë elektrike që konsumatorët do të kenë (parametrat që shërbejnë për kontrollin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike të ofruar për konsumatorët. Në funksion të kësaj, në njehsorë janë ngjarjet e regjistruara kur ka pasur ndërprerje).

|                                                                                  |                                        |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM    | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I OSSH-së | Faqe     | Faqe 57 prej 132  |
|                                                                                  |                                        | Versioni | 1.0               |

- Ekranet LCD (njehsorë elektronik është parametrizuar në mënyrë që në ekran të paraqiten vlera momentale të energjisë, rrymave, tensioneve, kohës / datës së matësit ku konsumatori mund të monitorojë këto të dhëna online).
- Matësit kanë ndërprerësin / ndërruesin mikro, i cili bën zbulimin e hapjes së terminalit të njehsorit (në rast të ndonjë hapjeje - regjistrohet koha e hapjes së terminalit të njehsorit)
- Konsumatori mund të përdorë energjinë në mënyrë më racionale

Sipas njehsorit që mundëson leximin nga largësia dhe përpunimi i të dhënave në metodën automatike, llogariten përfitimet e mëposhtme shtesë:

- Zvogëlimi i kohës për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave,
- Saktësia e të dhënave është më e lartë,
- Rritja e periudhës kohore për analizimin e rezultateve nga raportet e nxjerra, duke evidentuar bllokimet (fytet e ngushta), rëniet ose rritjet e tensionit, etj.
- Faturimi do të jetë automatikisht nga baza e shënimeve të aplikacionit, duke përjashtuar futjen së të dhënave me dorë në sistemin e faturimit.

#### *Projektet në Mitrovicën e Veriut – Viti 2026*

*Tabela 30. Materialet e nevojshme për Mitrovicën e Veriut.*

| Përshkrimi                         | Njësia | Sasia          |
|------------------------------------|--------|----------------|
| Ormana                             | copë   | 5,000          |
| Kabllo                             | m      | 100,000        |
| Fidosa                             | copë   | 30,000         |
| Gypa te brinjëzuar Ø32             | m      | 25,000         |
| Përforcues të gypave dhe kablllove | m      | 10,000         |
| <b>Total</b>                       | -      | <b>170,000</b> |

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 58 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

## 6. PROJEKTET NË LOGJISTIKË

### 6.1 Makinat

Operimet e përditshme të operatorit të sistemit të shpërndarjes, kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të makinerive, si mjetet e transportit ashtu edhe makinat profesionale të rënda. Në këtë drejtim, çdo vit për shkak të rritjes së numrit të km (distanca të përdorura), shpenzimet për shërbimin e rregullt rriten vazhdimisht. Njëherazi, për shkak të distancave të mëdha, si dhe infrastrukturës jo të duhur, po rriten edhe shpenzimet për shërbimet e parregullta. Efekti i shërbimeve të parregullta / dëmeve ndikon edhe në operimet e përditshme, pasi operimet në terren (Shkycja, Prishja, Leximi, etj.) shpesh duhet të ndalohen për shkak të numrit të mangët të automjeteve në dispozicion.

Kur u privatizua shërbimi i shpërndarjes, automjetet në dispozicion ishin shumë të vjetra dhe me kosto shumë të larta operative dhe të mirëmbajtjes. Prandaj, në vitin 2013, ishte e nevojshme dhe e justifikuar të Zyra e Rregullatorit për Energji blerja e automjeteve të reja, të cilat ishin të pajisura me sistemin e monitorimit, që mundëson ndjekjen online të automjeteve dhe për këtë arsye u ofruan shërbime më të mira operative. Kryesisht çdo vit është bërë zëvendësimi i automjeteve të vjetra për të ulur shpenzimet e mirëmbajtjes si dhe shpenzimet e karburantit. Përgjatë vitit bëjnë disa makineri punuese për të cilat parashikojmë zëvendësimin e tyre gjatë viteve të ardhshëm.

Duke pasur parasysh edhe rregulloren ligjore dhe atë teknike të lartpërmendura, si dhe kostot operative, OSSh kryen analiza dhe bën plane për blerjen e automjeteve të reja (sidomos makineritë e nevojshme të rënda - të cilat sigurojnë vazhdimësinë e operimeve të biznesit). Automjetet që do të zëvendësohen po shkaktojnë kosto të larta operative, duke përfshirë sasinë në rritje të karburantit të përdorur. Për më tepër, për shkak të jetëgjatësisë së tyre rreth 10 vite, automjetet duhet të zëvendësohen dhe / ose mirëmbahen më shumë sidomos për shkak të rrezikut të aksidenteve dhe mundësisë së humbjes së jetës që mund të shkaktojnë.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura sasia dhe plani dinamik i blerjes së automjeteve për vitin 2026:

*Tabela 31. Plani dinamik i blejeve të automjeteve për vitin 2026.*

| Përshkrimi                                  | Sasia |
|---------------------------------------------|-------|
| Automjete për operacione në terren          | 32    |
| Automjete speciale për operacione në terren | 18    |

Në tabelën në vijim janë të paraqitura sasia dhe plani dinamik i blerjes së automjeteve për vitet 2027 -2030.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 59 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

*Tabela 32. Plani Dinamik i Blerjes së Automjeteve (2027-2030)*

| Automjeti              | 2027      | 2028      | 2029      | 2030       |
|------------------------|-----------|-----------|-----------|------------|
|                        | [copë]    | [copë]    | [copë]    | [copë]     |
| Minivan                | 23        | 10        | 10        | 25         |
| Automjete - EV         |           | 20        | 20        | 10         |
| Automjete me platformë |           |           | 5         | 12         |
| 4x4 Pick-Up            | 5         | 5         | 5         | 50         |
| Automjete me vinç      |           | 1         | 1         | 5          |
| Piruner                |           |           |           |            |
| Ekskavatorë            |           | 1         | 2         | 2          |
| Rimorkio (për kamionë) |           |           |           | 1          |
| <b>TOTAL</b>           | <b>28</b> | <b>37</b> | <b>43</b> | <b>105</b> |

## 6.2 Ndërtesat

Me privatizimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes, pronarit të ri i janë dhënë 20 ndërtesa administrative , 42 TS 35/10, 8 depo dhe 27 objekte me qira. Megjithatë, shumica e tyre nuk ishin brenda kërkesave standarde dhe nuk ofruan mjedis të sigurt, andaj pas shqyrtimit të nevojave të kompanisë si dhe përdorimit të këtyre aseteve, u shfaq nevoja për investime. Që nga privatizimi (Maj 2013 - 2021), janë investuar mbi 2 milion euro në objektet e OSSH-së.

Arsyet kryesore për këto investime janë përmbledhur si më poshtë:

- Krijimi i kushteve më të mira për punonjësit e OSSH;
- Krijimi i zonave të rehatshme dhe miqësore për konsumatorët;
- Pamje më e mirë e ndërtesës nga jashtë dhe brenda duke respektuar planin urbanistik të qytetit dhe identifikimin e kompanisë;
- Krijimi i kushteve më të mira në TS, meqë ato kanë paraqitur rrezik të përhershëm për punonjësit, pajisjet elektrike dhe qytetarët - për shkak të çatisë dhe mureve të vjetra dhe të dëmtuara
- Krijimi i hapësirës më të mirë në depot ekzistuese të pajisjeve elektrike, dokumenteve me vlera të rëndësishme për kompaninë dhe shtetin.

Paralelisht me zhvillimin e vendit dhe sektorin e energjisë, OSSH do të vazhdojë me projektin e rinovimeve dhe ndërtimit të ri sipas nevojave të kompanisë.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 60 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

## 7. PROJEKTET NË IT

Sot, projektet e teknologjisë informatike janë investime me rëndësi të lartë për OSSh-në, të cilat përdoren në fushat e vazhdimësisë së biznesit (business continuity), efikasitetit, dhe komunikimit. Kategoritë në të cilat do të investohet nga OSSh për periudhën 2026 - 2030 janë përshkruar më poshtë:

- **Hardueri (Hardware)**
- **Softueri (Software)**
- **Sistemi ERP**
- **Siguria Kibernetike**
- **Data Qendra (Data Center)**
- **Rrjetet e TI (IT-së)**
- **Siguria Fizike (Physical Security)**
- **Projekti IS – U**

Pas liberalizimit të tregut të energjisë elektrike janë krijuar kërkesa të reja rregullatore, operacionale si dhe kërkesa për mbështetje të konsumatorëve, të cilat sistemi ynë aktual (i trashëguar) nuk arrin t'i përmbushë. Me rritjen e pritur të bazës së konsumatorëve dhe rritjes së kompleksitetit të operimit të tregut të energjisë siç është ndërrimi i furnizuesve, matja transparente e konsumit, faturimi dhe mirëmbajtja e furnizuesve aktiv dhe potencial, një zgjidhje e dëshmuar në industrinë e shërbimeve publike si SAP IS-U (Industry Solution for Utilities) është e domosdoshme.

SAP IS-U është një zgjidhje e zhvilluar posaçërisht nga SAP për kompanitë që operojnë në sektorin e energjisë dhe shërbimeve publike. IS-U ndihmon kompanitë që ofrojnë shërbime të energjisë elektrike, ujit, gazit dhe ngrohjes në menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të tyre. Ky modul integron dhe optimizon të gjitha proceset që lidhen me konsumatorët, matjen, faturimin, pagesat dhe shpërndarjen. IS-U rrit efikasitetin operacional të kompanive duke ndihmuar në menaxhimin e të gjitha proceseve që janë kritike për sektorin e energjisë.

SAP IS-U ofron:

- **Zgjidhje të integruara:** Siguron operim më efikas dhe më të koordinuar përmes integrimit të të gjitha proceseve të biznesit. Lejon kryerjen e operacioneve të shumta të biznesit në një mjedis të centralizuar dhe me një burim të vetëm të së vërtetës (single point of truth).
- **Menaxhim të të dhënave të mëdha- Big Data:** Mundëson menaxhimin e saktë dhe të sigurt të të dhënave të mëdha dhe komplekse. Ofron infrastrukturë që mund të përshtatet lehtësisht me rritjen e numrit të konsumatorëve si dhe redukton humbjet e të ardhurave.
- **Përputhshmëri me rregullatorin:** Mund të përshtatet me kornizën ligjore të aplikueshme për sektorin si dhe ofron zgjidhje që janë në përputhje të plotë me standardet e industrisë.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 61 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

- **Rritje të efikasitetit:** Përshejton vëllimin e punës duke eliminuar proceset manuale dhe duke ofruar mjete dhe fleksibilitet për t'iu përgjigjur lehtësisht ndryshimeve në treg, për të optimizuar operimin, dhe për të parandaluar dështimin e sistemit.

**Përmirësim të shërbimit të konsumatorëve:** Ofron kanale moderne të komunikimit me konsumatorë duke përmirësuar eksperiencën e tyre dhe duke i ofruar kompanisë vizibilitet të plotë dhe të integruar në të dhënat e secilit konsumator.

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 62 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

## 8. PËRKRAHJA E INTEGRIMIT TË BRE-VE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES

Sipas kodit të shpërndarjes, pragu i kapacitetit për t'u lidhur me rrjetin e shpërndarjes është 10 [MW], kështu që të gjitha impiantet e BRE-së me kapacitet më të madh se 10 [MW] do të lidhen në rrjetin e transmisionit. Bazuar në teknologjinë e turbinave të erës dhe evolucionin e madhësisë dhe disponueshmërinë e tregut sot dhe në të ardhmen e afërt, pritët që i gjithë gjenerimi i erës të lidhet me sistemin e transmisionit. Të gjitha teknologjitë e tjera (HCV, FV dhe biomasa) supozohet se janë të lidhura me sistemin e shpërndarjes (kapaciteti individual i stacionit)

Investimet në rrjetin e shpërndarjes do të kenë një ndikim të konsiderueshëm në përkrahjen e integritetit të burimeve të ripërtëritshme. Ato mund ti ndajmë në dy grupe duke u bazuar në natyrën e investimeve:

- **Investimet në tension të mesëm:** Me ndërrimin (rikonstruimin) e rrjetit ekzistues shpërndarës, duke rritur kapacitetin shpërndarës me anë të rritjes së përcësve ajror dhe atyre kabllor si dhe kalimin në nivelin 20 [kV], rregullimin e nivelit të tensionit, eliminimin e prishjeve të pa planifikuara, reduktimin e ndërprerjeve të planifikuara duke lokalizuar atë vetëm në pjesë të caktuara përmes stabilimenteve shpërndarëse do të ndikojë në përkrahjen e gjeneratorëve të burimeve të ripërtëritshme duke ju siguruar tensionin kualitativ, ndërprerje minimale me afat sa më të shkurtër kohor, mundësi të kyçjes më të lehtë (në fund të linjës me kapacitete gjeneruese më të mëdha) etj. Pra investimi në rrjetin e tensionit të mesëm përveç që do të ndikoj teknikisht do të ndikojë edhe në kosto të investimeve për shkak të mundësisë të kyçjes së gjeneratorëve sa më afërt rrjetit shpërndarës.
- **Investimet në tension të ulët:** Do të ndikojnë në mundësinë e kyçjeve të gjeneratorëve të vegjël me vetë konsum duke ju siguruar energji kualitative dhe ndërprerje sa më të rrallë dhe afatshkurtër. Po ashtu në konsumatorët me vetëprodhim do të ndikojë edhe investimi në ndërrimin e njehsorëve duke ju mundësuar saktësi më të lartë dhe mundësi të qasjes së konsumatorit për monitorimin e konsumit/prodhimit përmes njehsorëve smart.

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 63 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

## 9. PËRFUNDIMI

Siç është theksuar në pjesët e mëparshme, është shumë e rëndësishme të zhvillohet vazhdimisht rrjeti i shpërndarjes, veçanërisht në Kosovë, i cili ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Këto investime janë të nevojshme për OSSh-në për të siguruar shërbime të qëndrueshme dhe cilësore.

Megjithatë, në përgjithësi me këto investime deri në vitin 2028, OSSh do të ketë nivel më të ulët të humbjeve teknike dhe jo-teknike, përmirësim të profilit të tensionit, furnizime alternative të nënstacioneve dhe daljeve ashtu që për konsumatorin të ketë numër më të ulët të ndërprerjeve, përkatësisht përmirësim të indekseve të SAIDI, SAIFI dhe ENS, dhe të plotësimit të kriterit N-1. Po ashtu do të ketë përmirësim të cilësisë së shërbimeve, zgjerim të kapaciteteve, reagim më të shpejtë në çdo prishje potenciale, dhe jo vetëm.

Nevoja për rehabilitimin, zgjerimin, adaptimin dhe aplikimin e standardeve në asetet e sistemit të shpërndarjes është shumë e qartë. Për shkak të kushteve në terren që janë evidente dhe në përputhje me objektivat e rrjetit, nevoja për të orientuar investimet në nivelin e tensionit të ulët si projekte me prioritet të lartë, është e qartë; veçanërisht në fushën më problematike në të cilën ka nevojë për një zgjidhje emergjente dhe që ndikon në një numër më të madh të konsumatorëve. Projektet janë të fokusuar në rritjen e besueshmërisë duke zvogëluar ndërprerjet e energjisë elektrike për shkak të ngarkesës (duke përmirësuar SAIDI-n dhe SAIFI-n) në sajë të plotësimit të kriterit N-1 dhe duke zvogëluar ngarkesat në daljet e mbingarkuara. Dizajni i ri i projekteve do të sigurojë që kualiteti i përgjithshëm i tensionit të përmirësohet gjithashtu. Përmirësimet në kualitetin e tensionit dhe zvogëlimin e ngarkesave në daljet e mbingarkuara, do të rezultojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike.

Në bazë të analizave, investimi më i mirë për rrjetin 10 [kV] është kalimi prej nivelit më të ulët të tensionit në nivelin më të lartë të tensionit, në këtë rast kalimi prej nivelit 10 [kV] në nivelin 20 [kV] të tensionit. Këto projekte të kalimit nga niveli 10 [kV] në nivelin 20 [kV] të tensionit janë paraparë përmes transformatorëve ngritës ose NS 35/10(20) [kV] ose nënstacionet 110/20(10) [kV] ku transformatorët e kanë mundësinë e operimit në nivelin 20 [kV].

Për nivelin e rrjetit të tensionit të ulët do të ketë investime me fokus të theksuar, ku do të ketë rehabilitim dhe rikonstruim të rrjetit, ngritje të fuqisë së transformatorëve dhe nënstacione të reja. Është e rëndësishme të theksohet se disa nga përfitimet e OSSh-së janë të pamatshme, por megjithatë ato ndikojnë në të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike, duke përmirësuar shërbimet e shpërndarjes, rritjen e efikasitetit të fuqisë punëtore dhe cilësinë e furnizimit. Për më tepër, siç u tha më parë, disa nga projektet e parashikuara janë gjithashtu për shkak të kërkesave ligjore, siç janë zëvendësimet e njehsorëve, apo deri tek kërkesat e reja që rrjedhin nga ndryshimet në legjislacion (hapja e tregut). Zbatimi i këtyre projekteve do të mundësojë zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit, do të krijojë kushte të favorshme për konsum të sigurtë, cilësor dhe efikas të energjisë elektrike.

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 64 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

## SHTOJCA 1:

### Projektet në nivelin 35 [kV] – Përshkrimet dhe analizat teknike

#### Projektet Investive – 2028

- **Projekti : Linja 35 [kV] Gjilani 1 (110/35 kV) – Gjilani I (35/10 kV) , 06/28-10 [35kV]**

NS 35/10 [kV] Gjilani I furnizohet nga NS 110/35/10 [kV] Gjilani 1. Linja ka gjatësi 2.24 [km] dhe është e ndërtuar me shtylla metali me përçues Al/Fe 95/12 [mm<sup>2</sup>]. Për shkak të vlerës së lartë të Pmax, linja ngarkohet deri 111.67 [%].

Linja 35 [kV] Gjilani 1 - Gjilani I, përveç që furnizon NS 35/10 [kV] Gjilani, kjo linje vazhdon dhe furnizon NS 35/10 [kV] Gjilani IV, pastaj linja vazhdon deri te NS 35/10 [kV] Lladovë i cili ka furnizim alternative edhe nga NS 35/10 [kV] Klllokot.



Figura 8. Topologjia e linjës 35 [kV], Linja 35 kV Gjilani 1 (110/35 kV) – Gjilani I (35/10 kV).

Në mënyrë që të eliminohet mbingarkesa është propozuar që linja 35 [kV] Gjilani 1 - Gjilani I, të zëvendësohet me linjë nëntokësore me kablllo të tipit: XHE 49-A, 3x240/25 [mm<sup>2</sup>], 35 [kV].

Tabela 33. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Dalja TM |                       | Kërkesa<br>a<br>[MW] | Ngarkesa<br>Max. e Linjës<br>[%] | Humbje<br>t<br>[MWh] | Tensioni<br>Min. [p.u] | Nr.i<br>konsumatorëve |
|----------|-----------------------|----------------------|----------------------------------|----------------------|------------------------|-----------------------|
| Para     | Gjilani 1 - Gjilani I | 23.64                | 112.53                           | 290.80               | 0.98                   | 17,432                |
| Pas      | Gjilani 1 - Gjilani I | 23.64                | 74.06                            | 147.98               | 0.99                   | 17,432                |

\*Numri i konsumatorëve të NS 35/10 [kV] Gjilani I dhe NS 35/10 [kV] Gjilani IV

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 65 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

Me këtë propozim do të rritet kapaciteti i linjës dhe do të eliminohet mbingarkesa në linjën përkatëse dhe do të ketë rritje të sigurisë së furnizimit edhe për NS 35/10 [kV] Gjilani IV, i cili rregullisht furnizohet nga kjo linjë, por efekt pozitiv do të ketë edhe në unazën që lidhet me NS 110/35/10 [kV] Vitia. Përfitime tjera janë eliminimi i rrezikut pasi linja ajrore kalon në vendbanime me dendësi të madhe, lirimi i hapësirave për zhvillimin e qytetit, lehtësim për mirëmbajtje, zvogëlimi i humbjeve teknike.

- Projekti : Linja 35 [kV] Gjilani 1 (110/35 kV) – Gjilani IV (35/10 kV), 06/28-11 [35kV]**

NS 35/10 [kV] Gjilani IV furnizohet nga NS 35/10 [kV] Gjilani I. Linja ka gjatësi 4.28 [km] dhe është e ndërtuar me shtylla betoni me përçues Al/Fe 95/12 [mm<sup>2</sup>]. Linja kalon në pjesë të qytetit me zhvillim të hovshëm me ndërtim të lartë, ka vështirësi në mirëmbajtjen e linjës dhe ka rrezikshmëri të lartë.

Linja 35 [kV] Gjilani I - Gjilani IV, përveç që furnizon NS 35/10 [kV] Gjilani IV, kjo linje vazhdon dhe furnizon NS 35/10 [kV] Lladovë i cili ka furnizim alternative edhe nga NS 35/10 [kV] Kllokot.



Figura 9. Topologjia e linjës 35 [kV] Gjilani I - Gjilani IV në Google Earth.

Tabela 34. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Dalja TM |                        | Kërkesa<br>a<br>[MW] | Ngarkesa<br>Max. e Linjës<br>[%] | Humbjet<br>[MWh] | Tensioni<br>Min. [p.u] | Nr.i<br>konsumatorëve |
|----------|------------------------|----------------------|----------------------------------|------------------|------------------------|-----------------------|
| Para     | Gjilani I - Gjilani IV | 12.12                | 58.06                            | 178.12           | 0.97                   | 8,981                 |
| Pas      | Gjilani I - Gjilani IV | 12.12                | 48.83                            | 28.29            | 0.99                   | 8,981                 |

\*Numri i konsumatorëve të NS 35/10 [kV] Gjilani IV

Me këtë propozim do të zvogëlohen humbjet teknike, lirimi i hapësirave për zhvillimin e qytetit, lehtësim për mirëmbajtje, do të zvogëlohet gjatësia e linjës.

- Projekti: Peja 1 (110/35/10kV) – Gurrakoci (35/10kV), 03/28-01 35[kV]**

Furnizimi i NS Gurrakoci bëhet nëpërmjet linjës ajrore 35 [kV] e ndërtuar me shtylla të betonit, përçues Al/Çe 70 [mm<sup>2</sup>] dhe ka gjatësi 18.38 [km]. Në NS janë të instaluar dy transformatorë të fuqisë (4+8) [MVA]. Në vitin 2024 ngarkesa maksimale e linjës 35 [kV] ka qenë 12.07 [MW]. Si rezultat i distancës së madhe të linjës, seksionit të përçuesve dhe ngarkesës maksimale, kemi rënie të larta të tensionit dhe humbje të mëdha teknike. Kështu, vlerat e rënies së tensionit në nivelin 10 [kV] dhe 0.4 [kV] në regjionin e Gurrakocit

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 66 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

janë përtej kufijve të pranueshëm. Në figurën 9 është paraqitur në Google Earth topologjia ekzistuese e linjës 35 [kV] Peja 1 – Gurrakoci.

Propozohet që NS Gurrakoci të furnizohet nga NS Peja 1, duke instaluar një linjë të re nëntokësore me kabllo XHE49-A, 240 [mm<sup>2</sup>].



Figura 10. Topologjia e propozuar për furnizimin e NS Gurrakoci nga NS Peja 1.

Tabela 35. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Dalja TM |           | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni Min. [p.u] | Numri i ndërprerjeve | Nr.i konsumatorëve |
|----------|-----------|--------------|----------------------------|---------------|---------------------|----------------------|--------------------|
| Para     | Gurrakoci | 12.07        | 88.44                      | 2,743.02      | 0.888               | 20                   | 6290               |
| Pas      | Gurrakoci | 12.07        | 45.91                      | 888.77        | 0.964               |                      | 6290               |

## Projektet Investive – 2029

### • Projekti : Linja 35 [kV] Prizreni 1 – Prizreni III , 03/29-14 [35 kV]

Linja 35 [kV] Prizreni 1 – Prizreni III e furnizon NS 35/10 [kV] Prizreni. Linja është e ndërtuar linjë e dyfishtë me kabllo nëntokësore të tipit IPO 13 Cu 95 [mm<sup>2</sup>], dhe shfrytëzohet vetëm njëra linjë, pasi kabllo të linjës së dytë janë jashtë përdorimit. Duke pasur parasysh se nga NS 35/10 [kV] Prizreni III furnizohet një pjesë e qendrës së qytetit të Prizrenit, ndërsa kabllove që e furnizojnë këtë NS, nuk janë në gjendje të mirë propozohet të ndërtohet linjë kabllorë nëntokësore me seksion të kabllove 240 [mm<sup>2</sup>], si në figurën më poshtë.



Figura 11. Topologjia e propozuar e linjës 35 [kV] Prizreni 1 – Prizreni III.

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 67 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat para dhe pas investimit.

Tabela 36. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Linjat 35 [kV] |                           | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni minimal (kV) | Nr.i konsumatorëve |
|----------------|---------------------------|--------------|----------------------------|---------------|-----------------------|--------------------|
| Para           | Prizreni 1 – Prizreni III | 9.33         | 61.79                      | 50.13         | 1.00                  | 5,379              |
| Pas            | Prizreni 1 – Prizreni III | 9.33         | 34.46                      | 29.69         | 1.00                  | 5,379              |

- Projekti : Linja 35 [kV] Gjakova 1 – Gjakova III, 08/29-13 [35 kV]**

NS 35/10 [kV] kV Gjakova III furnizohet nëpërmjet linjës ajrore 35 [kV] Gjakova 1 – Gjakova III dhe linjës nëntokësore 10 [kV] Gjakova 2 – Gjakova III. Linja ajrore është e ndërtuar me shtylla te betonit dhe metalike me seksion të përçuesve Al/Fe 70 [mm<sup>2</sup>].

Meqenëse, linja ajrore kalon nëpër zonë të banuar të qytetit, propozohet të ndërtohet linjë kablllore nëntokësore me seksion të kablllove 240 [mm<sup>2</sup>], si në figurën më poshtë. Në këtë rast NS Gjakova III do të furnizohet vetëm nga NS Gjakova 1.



Figura 12. Topologjia e propozuar e linjës 35 [kV] Gjakova 1 – Gjakova III në Google Earth.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet e kalkulimeve të gjendjes së propozuar.

Tabela 37. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Linjat 35 [kV] |                           | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet (MWh) | Tensioni minimal (kV) | Nr.i konsumatorëve |
|----------------|---------------------------|--------------|----------------------------|---------------|-----------------------|--------------------|
| Para           | Para 35 [kV] GJ1 – GJ III | 7.65         | 55.85                      | 119.95        | 34.55                 | 3,702              |
|                | Para 10 [kV] GJ2 – GJ III | 5.44         | 51.86                      | 39.28         | 10.4                  | 2,560              |
| Pas            | Pas 35 [kV] GJ1 – GJ III  | 13.09        | 53.9                       | 29.29         | 34.48                 | 5,251              |

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 68 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

## Projektet në nivelin 10 [kV] – Përshkrimet

### Projektet Investive – 2026

- Projekti: Rruga e Reqanit 03/26-04 [10kV]**

Dalja 10 [kV] Rruga e Reqanit, e cila aktualisht ka segmente me shtylla druri dhe përçues me seksion të pamjaftueshëm prej 25 [mm<sup>2</sup>], duke ndikuar në sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike. Investimi parashikon zëvendësimin e përçuesve dhe shtyllave sipas gjendjes teknike, si dhe kalimin nga rrjeti ajror në rrjet nëntokësor në segmente të caktuara. Po ashtu, parashihet rikonfigurimi i rrjetit, ku dy trafostacione do të furnizohen nga dalja 10 [kV] Theranda 2. Implementimi i projektit do të rrisë besueshmërinë, sigurinë operative dhe cilësinë e furnizimit, si dhe do të mundësojë lidhje unazore me daljet e tjera të qytetit. Në vazhdim është paraqitur gjendja e propozuar e daljes. Linjat me ngjyrë të zezë duhet të demoloohen.




Figura 13. Topologjia e propozuar e daljes së re - Rruga e Reqanit 2.

Tabela 38. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Dalja TM |                     | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni Min. [p.u] | Nr.i konsumatorëve |
|----------|---------------------|--------------|----------------------------|---------------|---------------------|--------------------|
| Para     | J05 Rruga e Reqanit | 3.21         | 124.49                     | 632.97        | 0.91                | 1678               |
| Pas      | J05 Rruga e Reqanit | 3.08         | 81.73                      | 473.60        | 0.95                | 1553               |

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 69 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

- **Projekti: Bodrumi & Dalja e re Hasi I, 03/26-06 [10kV&20kV]**

Pas planifikimit të ndarjes së daljes Bodrumi dhe krijimit të daljes së re Hasi I, e cila operon në nivelin 20 [kV] dhe furnizohet nga NS 35/10(20) [kV] Pirana, dalja ekzistuese Bodrumi vazhdon operimin në nivelin 10 [kV] .Në vijim paraqitet topologjia e përditësuar e daljes Bodrumi, si dhe kalkulimet teknike përkatëse.




Figura 14. Topologjia e propozuar e daljes –Bodrumi 10 [kV]

Tabela 39. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

| Dalja TM |                 | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni Min. [p.u] | Numri i ndërprerjeve | Nr.i konsumatorëve |
|----------|-----------------|--------------|----------------------------|---------------|---------------------|----------------------|--------------------|
| Para     | Bodrumi         | 5.43         | 192.12                     | 1,314.92      | 0.73                | 149                  | 2334               |
|          | Rahoveci        | 5.41         | 156.96                     | 1,309.60      | 0.75                | 110                  | 1735               |
| Pas      | Bodrumi 10 [kV] | 3.27         | 78.52                      | 372.11        | 0.905               | -                    | 999                |
|          | Hasi I 20 [kV]* | 3.83         | 49.8                       | 256.43        | 0.974               | -                    | 2151               |
|          | Rahoveci*       | 3.68         | 105.95                     | 731.82        | 0.847               | -                    | 973                |

\*Pasi transferohen 23 TS-e nga dalja Bodrumi te dalja Hasi I

\*\*Pasi transferohen 3 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Hasi I dhe 6 TS-e nga dalja Rahoveci te dalja Bodrumi.

- **Projekti: Bresalci, 06/26-07 [10kV]**

Aktualisht, dalja Bresalci përballlet me mbingarkesë të theksuar, humbje teknike të konsiderueshme, si dhe rënie të mëdha të tensionit, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë, sigurinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e kësaj zone. Në figurën e mëposhtme paraqitet topologjia e re e propozuar, e cila synon optimizimin e rrjetit shpërndarës, uljen e humbjeve teknike, dhe rritjen e sigurisë në furnizim. Ndërtimi i linjave të reja nëntokësore përgjatë rrugëve të Ministrisë, duke shfrytëzuar kanalet ekzistuese në disa segmente (në fillim dhe përgjatë autostradës), si dhe ndërtimi i kanaleve të reja në zonat ku mungon infrastruktura ekzistuese. Ndërtimi i linjave të reja ajrore, në segmente ku është e mundur është

|                                                                                  |                                           |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM       | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I<br>OSSH-së | Faqe     | Faqe 70 prej 132  |
|                                                                                  |                                           | Versioni | 1.0               |

përdorur trasa ekzistuese me ndërrim të përçuesit, ndërsa në zona të pamundshme për shfrytëzim (për shkak të relievit malor), është ndërtuar trase e re. Ndërtimi i një stabilimenti të ri, i cili ndahet në disa degëzime për balancimin e ngarkesës dhe për përmirësimin e shpërndarjes së energjisë në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme.




Figura 15. Topologjia e propozuar e daljes - Bresalci.

Tabela 40. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

|      | Dalja TM         | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni Min. [p.u] | Numri i ndërprerjeve | Nr.i konsumatorëve |
|------|------------------|--------------|----------------------------|---------------|---------------------|----------------------|--------------------|
| Para | Bresalci- 10 kV  | 4.24         | 148.86                     | 1363.33       | 0.754               | 66                   | 2714               |
| Pas  | Bresalci - 10 kV | 3.45         | 63.41                      | 317.94        | 0.982               | -                    | 2714               |

Tabela 41. Të dhënat teknike, para dhe pas investimit.

|      | Dalja TM      | Kërkesa [MW] | Ngarkesa Max. e Linjës [%] | Humbjet [MWh] | Tensioni Min. [p.u] | Numri i ndërprerjeve | Nr.i konsumatorëve |
|------|---------------|--------------|----------------------------|---------------|---------------------|----------------------|--------------------|
| Para | Kufca- 10 kV  | 1.74         | 61.87                      | 250.21        | 0.90                | 38                   | 1337               |
| Pas  | Kufca - 10 kV | 2.57         | 63.32                      | 316.08        | 0.861               | -                    |                    |

\*Pasi të transferohen 5 transfostacione nga dalja J10 Bresalcit te dalja J06 Kufca

Është planifikuar që të transferohen 3 transformator nga dalja J10 Bresalci ne daljen J14 Rrethi, por kjo do te realizohet pasi të kryhet investimet ne daljen J14 Rrethi.

- **Projekti: Shipoli, Ibër Lepenci & Dalja e re, 07/26-03 [10kV]**

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
|                                                                                  | PLANI ZHVILLIMOR PESE VJEÇAR I      | Faqe     | Faqe 71 prej 132  |
|                                                                                  | OSSH-së                             | Versioni | 1.0               |

Topologjia ekzistuese e daljeve Shipoli dhe Ibër Lepenci përfshin degë dhe distanca të gjata që do të thotë që të dy daljet kanë rënie të tensionit. Gjithashtu pjesa më e madhe e rrjetit ekzistues të Shipolit përmban shtylla të vjetra prej druri dhe seksion ekzistues të përçuesve Al/Çe 25 [mm<sup>2</sup>] në zonën rurale.

Për të ulur ngarkesën dhe meqenëse furnizuesit ekzistues janë të mbingarkuar, topologjia e re përfshin krijimin e një dalje të re, paraqitur në figurat e mëposhtme.



Figura 16. Topologjia e propozuar e daljes - Iber Lepenci.



Figura 17. Topologjia e propozuar e daljes – Shipoli.

|                                                                                  |                                     |          |                   |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------|-------------------|
|  | NJËSIA PËR PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM | Nr.      | KEDS-DIV-O-DPP-01 |
